



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.26

27 mars

2012

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Ligj nr. 20/2012 datë 1.3.2012	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar.. 1295
Ligj nr. 21/2012 datë 1.3.2012	Për një ndryshim në ligjin nr. 9180, datë 5.2.2004 “Për statistikat zyrtare” 1297
Ligj nr. 22/2012 datë 1.3.2012	Për një ndryshim në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar 1298
Ligj nr. 23/2012 datë 1.3.2012	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar 1299
Vendim i Kuvendit nr. 13/2012, datë 1.3.2012	Për miratimin e raportit përfundimtar të Komisionit Hetimor “Për nisjen e procedurës së shkarkimit nga detyra të zotit Kreshnik Spahiu, Zëvendëskryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, ngritur me vendimin e Kuvendit nr. 2/2012, dhe shkarkimin e tij 1317
Vendim i Kuvendit nr. 14/2012, datë 1.3.2012	Për zgjatjen e afatit të Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore, ngritur me vendimin nr. 141, datë 17.11.2011..... 1318
Dekret nr. 7294 datë 1.3.2012	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare 1318
Vendim i KM nr. 193, datë 26.3.2012	Për lirimin dhe emërimin në detyrë të drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrimit të Zonave/Ndërtimeve Informale (ALUIZNI) 1319

Udhëzim i MF nr. 4, datë 28.2.2012	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 20, datë 8.9.2011 “Për metodat dhe procedurat e raportimit të subjekteve raportuese të ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar	1320
Udhëzim i MF nr. 5, datë 28.2.2012	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 21, datë 8.9.2011 “Për mënyrat dhe procedurat e raportimit të profesioneve të lira jofinanciare”	1325
Urdhër i MASH nr. 46, datë 9.2.2012	Për hapjen e programeve të studimit të ciklit të dytë “Master i shkencave” në shkollën e lartë universitare private “Sevasti dhe Parashqevi Qirjazi”	1329
Urdhër i MASH nr. 59, datë 17.2.2012	Për riorganizimin e njësive kryesore “Fakulteti i Farmacisë dhe Stomatologjisë” e “Fakulteti i Infermierisë” në “Fakulteti i Shkencave Mjekësore” të shkollës së lartë universitare jopublike “Universiteti Kristal”	1330
Urdhër i MASH nr. 60, datë 17.2.2012	Për lejimin e fillimit të veprimtarisë akademike të programeve të studimit, Akademisë Pedagogjike, Tiranë, në përputhje me licencën e dhënë	1331
Urdhër i MASH nr. 62, datë 17.2.2012	Për lejimin e fillimit të veprimtarisë akademike të programeve të studimit, Akademisë së Studimeve të Aplikuara, Durrës, në përputhje me licencën e dhënë ...	1332

LIGJ
Nr. 20/2012

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR. 8438, DATË 28.12.1998
“PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Neni 13 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 13

Deklarata individuale vjetore e të ardhurave

1. Tatimpaguesit individë, rezidentë në Republikën e Shqipërisë, që realizojnë të ardhura të tatueshme në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj, dorëzojnë deklaratën vjetore të të ardhurave pranë administratës tatimore qendrore. Deklarues të të ardhurave individuale vjetore janë edhe tatimpaguesit jorezidentë, të cilët krijojnë të ardhura të tatueshme me burim në Republikën e Shqipërisë.

2. Tatimpaguesit e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni dorëzojnë deklaratën vjetore të të ardhurave pranë administratës tatimore qendrore, jo më vonë se data 30 prill e vitit që pason periudhën tatimore, për të cilën bëhet deklarimi.

3. Çdo deklaratë individuale vjetore e të ardhurave plotësohet me numrin e identifikimit personal në letërnjoftimin e individit, i cili shërben si kodi fiskal i individit. Edhe në rastin kur individ është person jorezident në Republikën e Shqipërisë, si kod fiskal shërben numri i identifikimit personal në letërnjoftimin e individit.

4. Përfshihen nga detyrimi për plotësimin dhe dorëzimin e deklaratës individuale vjetore të të ardhurave të gjithë individët që realizojnë të ardhura bruto vjetore nga të gjitha burimet në shumën e përgjithshme më pak se 2 000 000 (dy milionë) lekë.

5. Përveç tatimpaguesve të parashikuar në këtë nen, deklarata vjetore e të ardhurave mund të plotësohet edhe nga persona të tjerë, që vendosin të bëjnë deklaratën, megjithëse nuk kanë detyrimin ligjor për këtë, për arsye se duan të përfitojnë nga skema e shpenzimeve të zbritshme, e parashikuar në këtë ligj, kur këta individë plotësojnë kushtet e përfitimit të zbritjes së shpenzimeve.”.

Neni 2

Në nenin 13/1, pas fjalisë së parë të pikës 2 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Brenda këtij afati, individit ka të drejtë të bëjë korrigjimin e deklaratës deri në dy herë, pa u penalizuar. Nëse nga ana e tij korrigjimi brenda këtij afati tremujor ndryshon për herë të tretë, ndaj tij aplikohen sanksionet, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 115 “Plotësimi i pasaktë i deklaratës tatimore dhe kërkesa e pasaktë për rimbursim” të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.”.



Neni 3

Në nenin 13/2, pas pikës 2 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Në rast se shuma e të ardhurave të përcaktuara në pikën 1 e tejkalon masën prej 2 000 000 (dy milionë) lekësh në vit, individit detyrohet të plotësojë dhe të dorëzojë deklaratën e të ardhurave individuale vjetore, vetëm nëse shuma e të ardhurave vjetore bruto, sipas pikës 1, e tejkalon shumën prej 2 000 000 (dy milionë) lekësh.”.

Neni 4

Neni 13/3 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 13/3

Shpenzimet e zbritshme

1. Tatimapaguesit, të cilët nuk janë subjekt i deklarimit, sipas pikës 4 të nenit 13 të këtij ligji, por duan të plotësojnë deklaratën në bazë të pikës 5 të nenit 13 të këtij ligji, dhe kanë të ardhura bruto vjetore nga të gjitha burimet deri në shumën 1 050 000 (një milion e pesëdhjetë mijë) lekë në vit (e indeksueshme çdo vit), por jo më të lartë se kjo shumë, mund të jenë subjekte deklaruese. Për efekt të llogaritjes së të ardhurës së tatueshme të këtyre individëve që plotësojnë deklaratën vjetore të të ardhurave, sipas pikës 5 të nenit 13 të këtij ligji, janë shpenzime të zbritshme shpenzimet e mëposhtme:

a) kontributet vullnetare në fondin e pensionit vullnetar dhe kontributet vullnetare të individit për jetën dhe shëndetin, të derdhura nga vetë individit. Kufiri maksimal i shpenzimeve, i njohur për kontributet vjetore, është kufiri i përcaktuar në ligjin nr. 10 197, datë 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar”;

b) shuma e interesit bankar të kredisë së marrë për shkollim, për vete apo për fëmijët dhe personat në kujdestari;

c) shpenzimet për mjekim, për vete apo për fëmijët dhe personat në kujdestari, për pjesën e pambuluar nga sigurimi i detyrueshëm shëndetësor, sipas përcaktimeve të rregulluara me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Personat jorezidentë nuk përfitojnë nga e drejta e llogaritjes së shpenzimeve të zbritshme, të parashikuara në pikën 1 të këtij neni.”.

Neni 5

Në nenin 13/5 pika 1, fjalia “Në rastin kur deklarata dorëzohet elektronikisht, dorazi apo me postë, skanime/fotokopje e këtyre dokumenteve i bashkëlidhen deklaratës vjetore të të ardhurave” shfuqizohet.

Neni 6

Në nenin 13/6 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Diferenca ndërmjet totalit të të ardhurave bruto dhe shpenzimeve të zbritshme përbën të ardhurën e tatueshme të individit, e cila tatohet, me shkallën tatimore në fuqi, 10 për qind. Shumës së këtij tatimi i zbriten tatimet e paguara gjatë periudhës tatimore, të dokumentuara nga mbajtësi në burim i këtyre tatimeve. Për individët rezidentë fiskalë shqiptarë, që kanë realizuar të ardhura dhe janë taksuar për to jashtë Republikës së Shqipërisë, në vende me të cilat Shqipëria ka nënshkruar marrëveshje për shmangien e taksimit të dyfishtë, tatimet e paguara, të vërtetuara nga autoritetet e këtyre vendeve, janë të

kreditueshme në masën e përcaktuar në marrëveshjet specifike. Në rast se të ardhurat i kanë realizuar dhe u janë taksuar jashtë Republikës së Shqipërisë, në vende me të cilat Shqipëria nuk ka nënshkruar marrëveshje për shmangien e taksimit të dyfishtë, tatimet e paguara nuk janë të kreditueshme.”.

2. Në pikën 2 fjalët “ brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së deklaratës vjetore të të ardhurave” zëvendësohen me fjalët “jo më vonë se data 30 prill”.

Neni 7

Në nenin 13/8 “data 31 shtator” zëvendësohet me datën “30 shtator”.

Neni 8

Në nenin 20 paragrafi i pestë shfuqizohet.

Neni 9

Në nenin 38 pika 7, paragrafi i fundit ndryshohet si më poshtë:

“Detyrimi i parë për deklarimin e të ardhurave individuale vjetore, për vitin fiskal 2011, nga subjektet e parashikuara në këtë ligj, duhet të bëhet jo më vonë se data 30 shtator 2012, ndërsa pagesa e tatimit, sipas pikës 2 të nenit 13/6, të bëhet jo më vonë se data 30 shtator 2012.

Kreditimi i shumave të përfituara nga skema e shpenzimeve të zbritshme, parashikuar në nenin 13/3 të këtij ligji, kryhet brenda datës 31 dhjetor të vitit që pason periudhën tatimore, për të cilën është hartuar deklarata, për vitin 2011. Për vitet e tjera vijuese fiskale, afatet e mësipërme janë jo më vonë se data 30 prill.”.

Neni 10

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 1.3.2012

**Shpallur me dekretin nr. 7338, datë 20.3.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ

Nr. 21/2012

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 9180, DATË 5.2.2004 “PËR STATISTIKAT ZYRTARE”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Në fund të pikës 1 të nenit 9 të ligjit nr. 9180, datë 5.2.2004 “Për statistikat zyrtare”, pas fjalëve “person juridik publik” shtohen fjalët “në varësi të Kryeministrit”.



Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 1.3.2012

**Shpallur me dekretin nr. 7339, datë 20.3.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ

Nr. 22/2012

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 9643, DATË 20.11.2006 “PËR PROKURIMIN PUBLIK”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, bëhet ky ndryshim:

Neni 1

Në pikën 3 të nenit 19/1 fjalët “në varësi të Këshillit të Ministrave” zëvendësohen me fjalët “në varësi të Kryeministrit”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 1.3.2012

**Shpallur me dekretin nr. 7340, datë 20.3.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ
Nr. 23/2012

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 7895, DATË 27.1.1995 “KODI PENAL I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 81 pika 2 shkronja “d” dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 6 paragrafi i dytë shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Kushti për dënueshmërinë e njëkohshme në territorin e shtetit tjetër nuk zbatohet në rastet e krimeve të korrupsionit në sektorin publik ose privat, si dhe të ushtrimit të ndikimit të paligjshëm.”.

Neni 2

Në nenin 7 paragrafi i dytë bëhen këto ndryshime:

1. Shkronja “e” hiqet.

2. Shkronja “h” ndryshohet si më poshtë:

“h) pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale;”.

3. Shkronja “i” ndryshohet si më poshtë:

“i) krimet e korrupsionit në sektorin publik ose privat, si dhe të ushtrimit të ndikimit të paligjshëm.”.

Neni 3

Në nenin 7/a paragrafi i parë, pas shkronjës “d” shtohet shkronja “dh” me këtë përmbajtje: “dh) financim terrorizmi.”.

Neni 4

Pas nenit 8 shtohet neni 9 me këtë përmbajtje:

“Neni 9

Personat e mbrojtur ndërkombëtarisht

Dispozitat e këtij Kodi zbatohen edhe për vepra penale të kryera ndaj personave të mbrojtur ndërkombëtarisht.

Person i mbrojtur ndërkombëtarisht, përveçse kur marrëveshjet ndërkombëtare, të ratifikuara nga shteti shqiptar, parashikojnë ndryshe, është:

a) kryetari i një shteti, përfshirë edhe anëtar i organit kolegjial që kryen funksionet e kryetarit të shtetit, sipas kushtetutës së atij shteti, kryetari i qeverisë ose ministri i punëve të jashtme, kur këta ndodhen në një shtet tjetër, si dhe anëtarët e familjes që i shoqërojnë;



b) çdo përfaqësues a zyrtar i një shteti ose çdo zyrtar apo agjent i një organizate ndërkombëtare me karakter ndërqeveritar, i cili, në kohën dhe vendin e kryerjes së veprës penale kundër tij, zyrës, banesës private ose mjeteve të tij të transportit, gëzon, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, mbrojtje të posaçme nga çdo sulm mbi personin, lirinë dhe dinjitetin e tij, si dhe anëtarët e familjes së tij.”.

Neni 5

Neni 9 “Përgjegjësia për personat e huaj që gëzojnë imunitet” numërohet neni 9/a i këtij Kodi.

Neni 6

Në nenin 30 shtohet pika 10 me këtë përmbajtje:
“10. Humbja e përgjegjësisë prindërore.”.

Neni 7

Pas nenit 43 shtohet neni 43/a me këtë përmbajtje:

“Neni 43/a

Humbja e përgjegjësisë prindërore

Humbja e përgjegjësisë prindërore jepet nga gjykata ndaj personit që e ushtron përgjegjësinë prindërore, kur ai dënohet si autor ose bashkëpunëtor në një vepër penale ndaj fëmijës ose si bashkëpunëtor me fëmijën në kryerjen e një veprë penale.”.

Neni 8

Në nenin 34 bëhen këto ndryshime:

1. Në fillim të paragrafit të gjashtë shtohen fjalitë me këtë përmbajtje:

“Gjykata jep dënimin me gjobë, pasi ka hetuar rreth aftësisë paguese të personit. Aftësia paguese përcaktohet nga gjendja personale dhe pasurore e personit, si dhe nga rrethana të tjera që lidhen me to.”.

2. Pas paragrafit të shtatë shtohen katër paragrafë me këtë përmbajtje:

“Kur i dënuari nuk e paguan gjobën dhe gjoba nuk mund të vilet nëpërmjet ekzekutimit të detyrueshëm, gjykata vendos zëvendësimin e gjobës me burgim, duke llogaritur pesë mijë lekë për një ditë burgim.

Kur i dënuari nuk mund të paguajë gjobën në afat pa fajin e tij dhe nëse kriteret, mbi të cilat është caktuar gjoba, kanë ndryshuar pas dhënies së vendimit dhe nuk e justifikojnë haptazi pagimin e gjobës, atëherë i dënuari mund të kërkojë:

a) shtyrje të afatit të pagesës së gjobës gjer në gjashtë muaj;

b) kryerjen e një pune me interes publik.

Nëse gjykata urdhëron kryerjen e një pune në interes publik zbatohen rregullat e nenit 63 të këtij Kodi.

Nëse gjoba nuk paguhet edhe pas shtyrjes së afatit ose nëse i dënuari nuk e kryen punën në interes publik, gjykata vendos zëvendësimin e gjobës me burgim.”.

3. Në paragrafin e parafundit shtohet një fjali me këtë përmbajtje:

“Nëse dispozita penale nuk parashikon dënim me burgim, maksimumi i dënimit me burgim konsiderohet gjashtë muaj”.

4. Në paragrafin e fundit numri “7” bëhet “8”.

Neni 9

Pas nenit 65 shtohet neni 65/a me këtë përmbajtje:

**“Neni 65/a
Periudha e sigurisë**

Gjykata, në dhënien e vendimit, mund të vendosë edhe caktimin e një periudhe sigurie, gjatë së cilës nuk lejohet zbatimi i nenit 64 të këtij Kodi, në rastet kur ekziston një nga këto rrethana:

- a) vepra penale, masa e dënimit të së cilës është mbi pesë vjet;
- b) kryerja e veprës penale është bërë me egërsi dhe mizori;
- c) kur vepra është kryer kundër fëmijëve, grave shtatzëna ose personave që, për shkaqe të ndryshme, nuk mund të mbrohen;
- ç) kur vepra është kryer duke përfituar nga marrëdhëniet familjare ose të bashkëjetesës;
- d) kur kryerja e veprës penale është shtyrë nga motive që kanë të bëjnë me gjininë, racën, fenë, kombësinë, gjuhën, bindjet politike, fetare ose sociale.

Periudha e sigurisë shtrihet për afatin kohor nga tre të katërtat e dënimit të dhënë nga gjykata deri në kohëzgjatjen e plotë të dënimit penal.”.

Neni 10

Në nenin 102/a paragrafi i parë, fjalët “nga dy gjer në shtatë vjet” zëvendësohen me fjalët “nga tre gjer në shtatë vjet”.

Neni 11

Në nenin 108, fjalët “gjer në pesë vjet” zëvendësohen me fjalët “nga tre gjer në shtatë vjet”.

Neni 12

Në nenin 113 shtohet paragrafi i dytë me këtë përmbajtje:

“Dhënia e shpërblimit për përfitim personal të prostitucionit dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.”.

Neni 13

Neni 119 ndryshohet si më poshtë:

**“Neni 119
Fyerja**

Fyerja e qëllimshme e personit përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga pesëdhjetë mijë gjer në një milion lekë.

Po kjo vepër, kur kryhet botërisht, në dëm të disa personave ose më shumë se një herë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga pesëdhjetë mijë gjer në tre milionë lekë.”.

Neni 14

Neni 120 ndryshohet si më poshtë:



“Neni 120

Shpifja

Përhapja e qëllimshme e thënieve, si dhe çdo informacion tjetër, duke e ditur se janë të rreme, që cenojnë nderin dhe dinjitetin e personit, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga pesëdhjetë mijë gjer në një milion e pesëqind mijë lekë.

Po kjo vepër, kur kryhet botërisht, në dëm të disa personave ose më shumë se një herë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga pesëdhjetë mijë gjer në tre milionë lekë.”.

Neni 15

Pas nenit 121 shtohet neni 121/a me këtë përmbajtje:

“Neni 121/a

Përndjekja

Kërcënimi ose ngacmimi i personit me anën e veprimeve të përsëritura, me qëllimin për t'i shkaktuar një gjendje të vazhdueshme dhe të rëndë ankthi apo frike për sigurinë vetjake, të një të afërmi ose të një personi, me të cilin ka lidhje shpirtërore, apo për ta detyruar të ndryshojë mënyrën e tij të jetesës, dënohet me burgim nga gjashtë muaj gjer në katër vjet.

Kur kjo vepër kryhet nga ish-bashkëshorti, ish-bashkëjetuesi apo personi që ka pasur lidhje shpirtërore me të dëmtuarin, dënimi rritet me një të tretat e dënimit të dhënë.

Kur kjo vepër kryhet ndaj të miturit, gruas shtatzënë ose një personi të pazotë për t'u mbrojtur, si dhe kur kryhet nga një person i maskuar ose shoqërohet me mbajtjen ose me përdorimin e armëve, dënimi rritet deri në një të dytën e dënimit të dhënë.”.

Neni 16

Në nenin 124/b paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë:

“Keqtrajtimi fizik ose psikologjik i të miturit nga prindërit, motra, vëllai, gjyshi, gjyshja, kujdestari ligjor ose çdo person që është i detyruar të kujdeset për të, dënohet me burgim nga tre muaj gjer në dy vjet.”.

Neni 17

Pas nenit 130 shtohet neni 130/a me këtë përmbajtje:

“Neni 130/a

Dhuna në familje

Rrahja, si dhe çdo vepër tjetër dhune, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, me pasojë cenimin e integritetit fizik, psiko-social dhe ekonomik të tij, dënohet me burgim gjer në dy vjet.

Kanosja serioze për vrasje ose plagosje të rëndë, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, me pasojë cenimin e integritetit psikik të tij, dënohet me burgim gjer në tre vjet.

Plagosja e kryer me dashje, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, që ka shkaktuar paaftësi të përkohshme në punë më tepër se nëntë ditë, dënohet me burgim gjer në pesë vjet.

Po këto vepra të kryera në mënyrë të përsëritur dënohen me burgim nga një vit gjer në pesë vjet.”.

Neni 18

Në nenin 134 paragrafi i parë, fjalët “me burgim nga tre muaj gjer në tre vjet” zëvendësohen me fjalët “me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet”.

Neni 19

Në nenin 135, në fund të tij, shtohen fjalët “dhe me gjobë nga treqind mijë gjer në një milion lekë”.

Neni 20

Pas nenit 143/a shtohen nenet 143/a/1- 143/a/7 me këtë përmbajtje:

“Neni 143/a/1

Manipulimi i tregut

Paraqitja jo e saktë, me dashje, e vlerës së një malli, shërbimi apo paraje, me qëllim çrregullimin e funksionimit të lirë dhe të drejtë të tregut, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në katër vjet.

Neni 143/a/2

Përdorimi i paautorizuar dhe përhapja e informacionit të privilegjuar

Personi, i cili, në mënyrë të autorizuar ose të paautorizuar, vihet në dijeni të informacionit të privilegjuar, për të cilin publiku nuk ka dijeni e që mund ta përdorë me qëllim fitimi material për vete, për një palë të tretë apo në dëm të kësaj të fundit, në njërin nga mënyrat e mëposhtme:

a) për të blerë ose për të shitur tituj të tregtueshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë ose të tregtuar nga një emetues, me seli në Republikën e Shqipërisë;

b) duke ditur natyrën e privilegjuar të informacionit, ia komunikon, pa autorizim, një palë të tretë;

c) duke ditur natyrën e privilegjuar të informacionit, këshillon një palë të tretë për të blerë ose për të shitur tituj të tregtueshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë apo të tregtuar nga një emetues, me seli në Republikën e Shqipërisë, dënohet me burgim nga gjashtë muaj gjer në tre vjet.

Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim, më shumë se një herë ose ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim gjer në pesë vjet.

Neni 143/a/3

Manipulimi i çmimeve dhe përhapja e informacionit të rremë

Veprimi apo mosveprimi i personit që:

a) nënshkruan një kontratë fiktive për shitjen apo zëvendësimin e titujve;

b) kryen porosi për blerje ose shitje të titujve, për të cilët është kryer porosia me të njëjtin çmim, apo nëse ai i përdor këto tituj si kundërporosi;

c) përhap informacion apo fakte të tjera të rreme për rritjen ose rënien e çmimit të titujve apo krijimin e një tregtimi fiktiv aktiv të tyre, me qëllim përfitimi personal për vete, një palë të tretë apo në dëm të kësaj të fundit, dënohet me burgim nga gjashtë muaj gjer në tre vjet.



Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim, më shumë se një herë ose ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga dy gjer në pesë vjet.

Neni 143/a/4

Paraqitja e të dhënave të rreme dhe shpërndarja e paautorizuar e tyre

Personi që, si anëtar i drejtorisë apo i këshillit mbikëqyrës të një emetuesi, lejon ose mundëson shpërndarjen e një prospekti, të ndryshëm nga ai që përcaktohet nga ligji, apo lejon ose mundëson paraqitjen e të dhënave të rreme ose paraqitjen e rreme të fakteve me vlerë materiale në një prospekt, dënohet me burgim nga gjashtë muaj gjer në tre vjet.

Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim, më shumë se një herë ose ka sjellë pasoja të rënda dënohet me burgim gjer në pesë vjet.

Neni 143/a/5

Regjistrimi i titujve në bursë në mënyrë të paautorizuar

Personi që, si anëtar i drejtorisë së bursës, lejon regjistrimin në kuotimin një, kuotimin e shoqërive anonime publike apo në kuotime të tjera të titujve, të cilët nuk i plotësojnë kushtet e ligjit për titujt, dënohet me burgim nga gjashtë muaj gjer në tre vjet.

Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim, më shumë se një herë ose ka sjellë pasoja të rënda dënohet me burgim nga dy gjer në pesë vjet.

Neni 143/a/6

Fshehja e pronësisë

Personi, i cili me dashje nuk i jep të dhëna për pronësinë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, sipas ligjit për titujt, dënohet me gjobë ose burgim gjer në një vit.

Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim, më shumë se një herë ose ka sjellë pasoja të rënda dënohet me burgim nga dy gjer në pesë vjet.

Neni 143/a/7

Tregtimi i paligjshëm i titujve

Personi që merret me ndërmjetësim të paautorizuar për blerjen ose shitjen e titujve dënohet me gjobë ose me burgim gjer në një vit.

Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim, më shumë se një herë ose ka sjellë pasoja të rënda dënohet me burgim nga dy gjer në pesë vjet.”.

Neni 21

Pas nenit 149 shtohen nenet 149/a dhe 149/b me këtë përmbajtje:

“Neni 149/a

Shkelja e të drejtave të pronësisë industriale

Prodhimi, shpërndarja, mbajtja për qëllime tregtimi, shitja, ofrimi për shitje, furnizimi, shpërndarja, eksportimi ose importimi për këto qëllime i:

a) produktit ose procesit të mbrojtur nga një patentë, pa pëlqimin e pronarit të patentës;

b) produktit që mbrohet nga një dizenjo industriale, pa pëlqimin e pronarit të dizenjosh industriale;

c) mallrave ose shërbimeve që mbrohen nga një markë tregtare, pa pëlqimin e pronarit të markës tregtare;

ç) produktit që rrjedh nga një tregues gjeografik, pa pëlqimin e pronarit të treguesit gjeografik; të kryera me dashje, përbëjnë kundërvajtje penale dhe dënohen me gjobë ose me burgim gjer në një vit.

Po kjo vepër kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet.”.

Neni 149/b

Shkelja e të drejtave të topografisë së qarkut të gjysmëpërçuesit

Prodhimi, përdorimi, mbajtja për qëllim tregtimi, shitja, ofrimi për shitje, furnizimi, shpërndarja, eksportimi ose importimi për këto qëllime i produktit që shkel të drejtat e topografisë së regjistruar të qarkut, të gjysmëpërçuesit ose të qarkut të integruar, pa pëlqimin e pronarit të topografisë, të kryera me dashje, përbëjnë kundërvajtje penale dhe dënohen me gjobë ose me burgim gjer në një vit.

Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet.”.

Neni 22

Në nenin 164/a bëhen këto ndryshime:

1. Fjalët “përbëjnë kundërvajtje penale dhe” hiqen.
2. Fjalët “dy vjet dhe me gjobë nga dyqind mijë gjer në një milion lekë” zëvendësohen me fjalët “tre vjet dhe me gjobë nga dyqind mijë gjer në një milion lekë”.

Neni 23

Në nenin 164/b, fjalët “tre vjet” zëvendësohen me fjalët “pesë vjet”.

Neni 24

Në nenin 226 bëhen këto ndryshime:

1. Titulli i nenit bëhet “Veprat e dhunshme ndaj personave të mbrojtur ndërkombëtarisht”.
2. Fjalët “kryetarëve, anëtarëve të qeverisë, parlamentarëve të shteteve të huaja, përfaqësuesve diplomatikë apo të organizmave të njohur ndërkombëtarë, që ndodhen zyrtarisht në Republikën e Shqipërisë”, zëvendësohen me fjalët “personave të mbrojtur ndërkombëtarisht”.

Neni 25

Në Kreun III, pas Seksionit IV shtohet Seksioni IV/1 “Vepra penale në lidhje me ushtrimin e veprimtarive financiare” me këtë përmbajtje:



“Seksioni IV/1

**Vepra penale në lidhje me ushtrimin e veprimtarive bankare
dhe financiare**

Neni 170/c

Ushtrimi pa licencë i veprimtarisë bankare

Ushtrimi i veprimtarisë bankare nga persona që nuk janë të licencuar për këtë qëllim, sipas legjislacionit bankar në fuqi, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.

Po kjo vepër, kur i ka shkaktuar pasoja të rënda interesave shtetërorë ose atyre të shtetasve, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në shtatë vjet.

Neni 170/ç

Ushtrimi pa licencë i veprimtarive financiare

Ushtrimi i një ose disa veprimtarive financiare të ndryshme nga veprimtaria bankare, nga persona që nuk janë të licencuar për këtë qëllim, sipas legjislacionit bankar dhe/ose financiar në fuqi, dënohet me gjobë ose burgim gjer në tre vjet.

Po kjo vepër, kur i ka shkaktuar pasoja të rënda interesave shtetërorë ose atyre të shtetasve, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet.”.

Neni 26

Në nenin 228 bëhen këto ndryshime:

1. Titulli i nenit bëhet “Veprimet e dhunshme ndaj vendeve të punës së personave të mbrojtur ndërkombëtarisht”.

2. Fjalët “përfaqësuesve të shteteve të huaja dhe organizmave të njohur ndërkombëtarë” zëvendësohen me fjalët “personave të mbrojtur ndërkombëtarisht”.

Neni 27

Neni 230 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 230

Vepra me qëllime terroriste

Kryerja e veprave të mëposhtme, me qëllim përhapjen e panikut në popullatë ose për të detyruar organe shtetërore, shqiptare ose të huaja, të kryejnë ose të mos kryejnë një akt të caktuar, ose për të shkatërruar apo destabilizuar, në mënyrë serioze, struktura thelbësore politike, kushtetuese, ekonomike ose sociale të shtetit shqiptar, të një shteti tjetër, institucioni apo organizate ndërkombëtare, dënohet me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm.

Veprat me qëllime terroriste përfshijnë:

- a) veprat kundër personit, të cilat mund të shkaktojnë vdekjen ose plagosjen e rëndë;
- b) rrëmbimin e avionëve, të anijeve, të mjeteve të tjera të transportit apo të platformave fikse ose ushtrimin e paligjshëm të kontrollit mbi to, me dhunë ose nëpërmjet kanosjes për përdorimin e dhunës apo me anë të çdo forme tjetër kanosjeje;
- c) kryerjen e akteve të dhunës kundër një personi në bordin e një avioni në fluturim, në bordin e një anijeje ose në bordin e një platforme fikse, kur këto akte mund të rrezikojnë sigurinë e avionit, të mjetit të lundrimit ose të platformës fikse;

c) shkatërrimin e një avioni në funksionim, të një anijeje apo të një platforme fikse ose shkaktimin e dëmeve të tilla avionit, anijes a ngarkesës së saj ose platformës fikse, që e bëjnë të pamundur ose rrezikojnë a mund të rrezikojnë sigurinë e fluturimit, të lundrimit ose të platformës fikse;

d) vendosjen, me çdo mjet, në një avion në shërbim, në një anije ose në një platformë fikse, të një pajisjeje a substance që mund të shkatërrojë avionin, anijen a platformën fikse ose që mund t'i shkaktojë dëme avionit, anijes a ngarkesës së saj ose platformës fikse dhe që rrezikon a mund të rrezikojë sigurinë e fluturimit, lundrimit të anijes ose të platformës fikse;

dh) shkatërrimin ose dëmtimin e pajisjeve të fluturimit apo të pajisjeve të lundrimit detar ose ndërhyrjen në funksionimin e tyre, kur nga një akt i tillë mund të rrezikohet siguria e avionit apo e anijes;

e) përhapjen e informacioneve që dihet se janë të pavërteta, duke rrezikuar sigurinë e një avioni në fluturim apo të anijes në lundrim;

ë) vrasjen ose rrëmbimin e një personi të mbrojtur ndërkombëtarisht, sipas nenit 9 të këtij Kodi, ose çdo sulm tjetër ndaj tij ose lirisë së tij;

f) sulmin e dhunshëm ndaj zyrës, banesës private ose mjetit të transportit të personit të mbrojtur ndërkombëtarisht, sipas nenit 9 të këtij Kodi, kur prej këtij sulmi rrezikohet personi ose liria e tij;

g) pengmarrjen ose rrëmbimin e personit dhe kanosjen për të vrarë, për të plagosur ose për të vazhduar mbajtjen e tij peng;

gj) marrjen në dorëzim, posedimin, përdorimin, transferimin, tjetërsimin, disponimin ose përhapjen e materialit bërthamor, me dashje dhe pa qenë i autorizuar ligjërisht, kur i shkaktohet ose mund t'i shkaktohet vdekja ose dëmtime të rënda çdo personi ose të dëmtohet rëndë prona;

h) vjedhjen, përvetësimin ose përfitimin nëpërmjet mashtrimit të materialeve bërthamore;

i) kërkimin e materialeve bërthamore, duke përdorur shtrëngimin, dhunën ose çdo formë tjetër kanosjeje;

j) prodhimin, mbajtjen, blerjen, transportin apo tregtimin e lëndëve plasëse, të armëve të zjarrit, biologjike, kimike apo bërthamore, si dhe kërkimin shkencor për prodhimin e armëve të shkatërrimit në masë;

k) kryerjen e akteve të dhunës, duke përdorur çdo pajisje, substancë ose armë, kundër një personi në një aeroport të aviacionit civil ndërkombëtar, kur këto akte shkaktojnë ose mund të shkaktojnë dëmtime të rënda ose vdekjen e personave;

l) shkatërrimin ose dëmtimin e rëndë të mjediseve apo të pajisjeve në një aeroport të aviacionit civil ndërkombëtar ose në një avion të vendosur në këtë aeroport që nuk është në fluturim ose ndërprerjen e shërbimeve të aeroportit, duke përdorur çdo pajisje ose armë, kur nga ky akt rrezikohet a mund të rrezikohet siguria e aeroportit;

ll) përhapjen, vendosjen, shkarkimin ose shpërthimin e lëndëve plasëse ose të pajisjeve të tjera vdekjeprurëse, në mjedise publike, në zyrat e një shteti ose qeverie, sistemin e transportit publik ose në infrastrukturën publike, si dhe shpërndarjen në mjedis të substancave të rrezikshme, shkaktimin e zjarreve, të përmytjeve, shpërthimeve, me qëllim shkaktimin e vdekjes ose dëmtimeve të rënda trupore ose me qëllim shkaktimin e shkatërtimeve masive të vendeve, mjediseve ose sistemeve të lartpërmendura, kur ky shkatërrim sjell a mund të sjellë humbje të mëdha ekonomike;

m) shkatërrimin e rëndë dhe në përmasa të mëdha të pronës publike, të infrastrukturës publike, të sistemit të transportit, të sistemit të informacionit e të pronës private, duke rrezikuar jetën e personave;

n) shkaktimin e ndërprerjes së furnizimit me ujë, energji elektrike ose çdo burim tjetër të rëndësishëm;

apo çdo vepër tjetër që synon të shkaktojë vdekjen ose plagosjen e rëndë të civilëve ose të çdo personi tjetër që nuk merr pjesë aktive në veprimet luftarake në një situatë konflikti të armatosur, e kryer për qëllimet e përcaktuara në paragrafin e parë të këtij neni.

Veprimet që shkaktojnë ndërprerjen e një shërbimi të rëndësishëm, një sistemi, një veprimtarie publike ose private, si rezultat i protestës, i mosbindjes civile, ose i grevës, nuk do të konsiderohen vepra me qëllime terroriste në kuptimin e këtij neni.”.



Neni 28

Neni 230/a ndryshohet si më poshtë:

“Neni 230/a

Financimi i terrorizmit

Dhënia ose grumbullimi i fondeve, me çdo mjet, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, me qëllimin që ato të përdoren ose duke ditur se ato do të përdoren, plotësisht ose pjesërisht:

- a) për të kryer vepra me qëllime terroriste;
- b) nga një organizatë terroriste;
- c) nga një terrorist i vetëm;

dënohet jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet burgim ose me burgim të përjetshëm dhe me gjobë nga pesë milionë lekë gjer në dhjetë milionë lekë.

Dispozitat e këtij neni zbatohen:

a) për të gjitha fondet, ku përfshihen pasuri të çdo lloji, të trupëzuara ose të patrupëzuara, të luajtshme ose të paluajtshme, pavarësisht nga mënyra e fitimit të tyre, dhe dokumente ligjore ose instrumente të çdo lloji, edhe në formë elektronike ose digjitale, që tregojnë të drejta ose interesa mbi pasuri të tilla, përfshirë kreditë bankare, çeqet e udhëtarëve, çeqet bankare, urdhërpagesat, aksionet, letrat me vlerë, bonot, çeqet e garantuara bankare, letrat e kreditit, si dhe çdo instrument tjetër financiar, të ngjashëm me to;

b) pavarësisht nëse personi që kryen një nga veprat e parashikuara në paragrafin e parë të këtij neni, ndodhet në të njëjtin shtet a në një shtet të ndryshëm nga ai, në të cilin ndodhet organizata terroriste a terroristi i vetëm ose nga shteti në të cilin është kryer a do të kryhet vepra me qëllime terroriste;

c) në rastin e parashikuar nga paragrafi i parë i këtij neni, pavarësisht nëse fondet janë përdorur në fakt për të kryer veprën ose veprat, për të cilat ishin dhënë ose grumbulluar, apo nëse mund të vendoset një lidhje mes fondeve dhe një apo më shumë veprave konkrete me qëllime terroriste.

Dijenja dhe qëllimi, sipas paragrafit të parë të këtij neni, nxirren nga rrethana fakti objektive.”.

Neni 29

Pas nenit 244 shtohet neni 244/a me këtë përmbajtje:

“Neni 244/a

Korrupsioni aktiv i nëpunësve të huaj publikë

Premtimi, propozimi ose dhënia, drejtpërdrejt a tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt, për vete ose për persona të tjerë, nëpunësit të huaj publik, nëpunësit të një organizate publike ndërkombëtare, anëtarit të një asambleje të huaj publike apo anëtarit të një asambleje ndërkombëtare parlamentare, për të kryer ose për të mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohen me burgim, nga gjashtë muaj gjer në tre vjet dhe me gjobë nga treqind mijë gjer në tre milionë lekë.”.

Neni 30

Në nenin 245/1 paragrafi i parë bëhen këto ndryshime:

1. Fjalët “përbëjnë vepër penale dhe” hiqen.
2. Fjalët “dy vjet” zëvendësohen me fjalët “tre vjet”.

Neni 31

Pas nenit 246 shtohet neni 246/a me këtë përmbajtje:

“Neni 246/a

**Ushtrimi i profesionit të ekspertit kontabël dhe i shoqërisë audituese
pa qenë i regjistruar**

Përvetësimi i titullit profesional të ekspertit kontabël, ushtrimi i profesionit të ekspertit kontabël apo përdorimi i emërtimeve, si shoqëri audituese, pa qenë regjistruar më parë në regjistrin publik të ekspertëve kontabël, si dhe përdorimi i çfarëdo titulli, që synon të krijojë një ngjashmëri ose një konfuzion me këta tituj profesionalë apo emërtime, kur është dhënë më parë masë administrative, përbëjnë kundërvajtje penale dhe dënohen me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet.”.

Neni 32

Pas nenit 248 shtohet neni 248/a me këtë përmbajtje:

“Neni 248/a

Dhënia në kundërshtim me ligjin e pensioneve ose e të ardhurave të tjera nga sigurimet shoqërore

Dhënia në kundërshtim me ligjin e pensioneve ose e të ardhurave të tjera nga sigurimet shoqërore prej punonjësit, që ka detyrë t'i japë ato, dënohet me burgim, nga gjashtë muaj gjer në shtatë vjet dhe me gjobë nga treqind mijë gjer në një milion lekë .”.

Neni 33

Në titullin dhe në tekstin e nenit 257/a, pas fjalëve “nëpunësve publikë” shtohen fjalët “ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim”.

Neni 34

Në nenin 258, fjalët “me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet” zëvendësohen me fjalët “me burgim gjer në tre vjet”.

Neni 35

Pas nenit 259 shtohet neni 259/a me këtë përmbajtje:

“Neni 259/a

Korrupsioni pasiv i nëpunësve të huaj publikë

Kërkimi ose marrja, drejtpërdrejt a tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt apo i një premtimi të tillë, për vete ose për persona të tjerë, ose pranimi i një oferte a premtimi që vjen nga përfitimi i parregullt, nga nëpunësi i huaj publik, nëpunësi i një organizate publike ndërkombëtare, anëtar i një asambleje të huaj publike apo anëtar i një asambleje ndërkombëtare parlamentare, për të kryer ose për të mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohet me burgim nga dy gjer në tetë vjet dhe me gjobë nga pesëqind mijë gjer në tre milionë lekë.”.



Neni 36

Neni 268 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 268

Poshtërimi i Republikës dhe i simboleve të saj

Dëmtimi i qëllimshëm i flamurit ose i stemës së Republikës, të ekspozuara në institucionet shtetërore, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre muaj.

Poshtërimi botërisht i flamurit ose i himnit kombëtar, gjatë zhvillimit të një veprimtarie të organizuar nga autoritetet shtetërore, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre muaj.”.

Neni 37

Neni 287 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 287

Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale

Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, nëpërmjet:

a) këmbimit ose transferimit të pasurisë, me qëllim fshehjen ose mbulimin e origjinës së paligjshme të saj, duke ditur se kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale;

b) fshehjes ose mbulimit të natyrës së vërtetë, burimit, vendndodhjes, disponimit, zhvendosjes, pronësisë ose të drejtave në lidhje me pasurinë, duke ditur që kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale;

c) fitimit të pronësisë, posedimit ose përdorimit të pasurisë, duke e ditur në çastin e marrjes në dorëzim të saj, që kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale;

ç) kryerjes së veprimeve financiare ose transaksioneve të copëzuara për shmangien nga raportimi, sipas legjislacionit për parandalimin e pastrimit të parave;

d) investimit në veprimtari ekonomike ose financiare të parave a sendeve, duke ditur se janë produkte të veprës penale ose veprimtarisë kriminale;

dh) këshillimit, ndihmës, nxitjes ose thirrjes publike për kryerjen e secilës prej veprave të përcaktuara më sipër;

dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet dhe me gjobë nga pesëqind mijë gjer në pesë milionë lekë.

Kur kjo vepër kryhet gjatë ushtrimit të një veprimtarie profesionale, në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga shtatë gjer në pesëmbëdhjetë vjet dhe me gjobë nga tetëqind mijë gjer në tetë milionë lekë.

E njëjta vepër, kur ka sjellë pasoja të rënda, dënohet jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet me burgim dhe me gjobë nga tre milionë gjer në dhjetë milionë lekë.

Dispozitat e këtij neni zbatohen edhe kur:

a) vepra penale, produktet e së cilës pastrohen, është kryer nga një person që nuk mund të merret si i pandehur ose që nuk mund të dënohet;

b) ndjekja penale për veprën, produktet e së cilës pastrohen, është parashkruar ose amnistuar;

c) personi që kryen pastrimin e produkteve është i njëjtë me personin që ka kryer veprën, nga e cila kanë rrjedhur produktet;

ç) për veprën penale, nga e cila kanë ardhur produktet, nuk është filluar asnjëherë çështja penale apo nuk është dhënë një dënim me vendim penal të formës së prerë;

d) vepra penale, produktet e së cilës pastrohen, është kryer nga një person, pavarësisht shtetësisë së tij, jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe është njëkohësisht e dënueshme, si në shtetin e huaj, ashtu edhe në Republikën e Shqipërisë.

Dijenja dhe qëllimi, sipas paragrafit të parë të këtij neni, nxirren nga rrethana fakti objektive.”.

Neni 38

Neni 287/b ndryshohet si më poshtë:

“Neni 287/b

Përvetësimi i parave ose mallrave që rrjedhin nga vepra penale ose veprimtaria kriminale

Kushdo që blen, merr, fsheh apo, në një mënyrë tjetër, përvetëson për vete ose një palë të tretë, apo ndihmon në blerjen, marrjen, fshehjen ose përdorimin e parave apo mallrave të tjera, duke ditur se një person tjetër ka përfituar këto para apo mallra, si pasojë e kryerjes së një vepre penale ose veprimtarie kriminale, dënohet me burgim nga gjashtë muaj gjer në tre vjet dhe me gjobë gjer në pesëqind mijë lekë.

Paragrafi i parë i këtij neni zbatohet pavarësisht ndalimit ligjor për të marrë në përgjegjësi penale personin që ka kryer veprën penale, nga e cila rrjedh përvetësimi i parave ose i mallrave të tjera.”.

Neni 39

Pas nenit 295/a shtohet neni 295/b me këtë përmbajtje:

“Neni 295/b

Shfrytëzimi i paligjshëm i të dhënave tregtare

Tregtimi i një malli apo ofrimi i një shërbimi nëpërmjet përdorimit të informacionit ose të dhënave që përbëjnë sekret tregtar ose informacion të privilegjuar nga persona që e kanë ose duhet ta kenë këtë informacion apo të dhënë, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në katër vjet.”.

Neni 40

Neni 318 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 318

Fyerja e gjyqtarit

Fyerja e gjyqtarit apo anëtarëve të trupit gjykues, prokurorit, avokatit ose anëtarit të arbitrazhit, për shkak të veprimtarisë së tyre në një çështje, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre muaj.”.

Neni 41

Neni 319/a “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë” numërohet neni 319/ç.

Neni 42

Pas nenit 319 shtohen nenet 319/a, 319/b dhe 319/c me këtë përmbajtje:



“Neni 319/a

Korrupsioni aktiv i gjyqtarit ose i zyrtarit të gjykatave ndërkombëtare

Premtimi, propozimi ose dhënia, drejtpërdrejt a tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt, për vete ose për persona të tjerë, gjyqtarit ose zyrtarit të gjykatave ndërkombëtare, për të kryer apo për të mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohen me burgim nga një vit gjer në katër vjet dhe me gjobë nga katërqind mijë gjer në dy milionë lekë.

Neni 319/b

Korrupsioni aktiv i arbitrit vendas dhe të huaj

Premtimi, propozimi ose dhënia, drejtpërdrejt a tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt, për vete ose për persona të tjerë, arbitrit vendas ose të huaj, për të kryer apo për të mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohen me burgim nga një vit gjer në katër vjet dhe me gjobë nga katërqind mijë gjer në dy milionë lekë.

Neni 319/c

Korrupsioni aktiv i anëtarëve të jurive gjyqësore të huaja

Premtimi, propozimi ose dhënia, drejtpërdrejt a tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt, për vete ose për persona të tjerë, i anëtarëve të jurive gjyqësore të huaja, për të kryer apo për të mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohen me burgim nga një vit gjer në katër vjet dhe me gjobë nga katërqind mijë gjer në dy milionë lekë.”.

Neni 43

Pas nenit 319/ç shtohen nenet 319/d, 319/dh dhe 319/e me këtë përmbajtje:

“Neni 319/d

Korrupsioni pasiv i gjyqtarit ose i zyrtarit të gjykatave ndërkombëtare

Kërkimi ose marrja, drejtpërdrejt a tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt ose i një premtimi të tillë, për vete ose për persona të tjerë, apo pranimi i një oferte a premtimi që vjen nga përfitimi i parregullt, nga gjyqtari ose zyrtari i një gjykate ndërkombëtare, për të kryer apo për të mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohet me burgim nga tre gjer në dhjetë vjet dhe me gjobë nga tetëqind mijë gjer në katër milionë lekë.

Neni 319/dh

Korrupsioni pasiv i arbitrit vendas dhe të huaj

Kërkimi ose marrja, drejtpërdrejt a tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt ose i një premtimi të tillë, për vete ose për persona të tjerë, apo pranimi i një oferte a premtimi që vjen nga përfitimi i parregullt, nga arbitri vendas ose i huaj për të kryer apo për të mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohet me burgim nga dy gjer në tetë vjet dhe me gjobë nga tetëqind mijë gjer në katër milionë lekë.

Neni 319/e

Korrupsioni pasiv i anëtarëve të jurive gjyqësore të huaja

Kërkimi ose marrja, drejtpërdrejt a tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt ose i një premtimi të tillë, për vete a për persona të tjerë, apo pranimi i një oferte a premtimi që vjen nga përfitimi i parregullt, nga një anëtar i jurive gjyqësore të huaja, për të kryer apo për të mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohet me burgim nga dy gjer në tetë vjet dhe me gjobë nga tetëqind mijë gjer në katër milionë lekë.”.

Neni 44

Në nenin 321, pas paragrafit të parë shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Kryerja e veprimeve në kundërshtim me vendimin e gjykatës, në lidhje me detyrat e lindura nga urdhrat e mbrojtjes të dhëna prej saj, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me burgim gjer në dy vjet.”.

Neni 45

Neni 325 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 325

Pengimi i subjekteve zgjedhore

Pengimi me anë të kanosjes, dhunës, apo me çdo mënyrë tjetër i subjekteve zgjedhore apo i kandidatëve për të zhvilluar veprimtarinë e tyre në përputhje me ligjin gjatë fushatës zgjedhore, dënohet me burgim nga tre muaj gjer në tre vjet.”.

Neni 46

Neni 326 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 326

Falsifikimi i materialit zgjedhor dhe rezultateve të zgjedhjeve

Falsifikimi, shpërndarja ose përdorimi i fletëve të votimit, i dokumenteve dhe materialit zgjedhor, me qëllim ndryshmin e rezultatit të zgjedhjeve nëpërmjet paraqitjes në to të të dhënave, që dihen se janë të pasakta, zëvendësimi i të saktave me të rreme ose nëpërmjet futjes në kuti të fletëve të votimit në mënyrë të paligjshme dënohet me burgim nga një gjer në pesë vjet.

Po kjo vepër kur kryhet nga personat që kanë për detyrë të administrojnë procesin zgjedhor, ose ka sjellë pasoja të rënda në mbarëvajtjen e votimit, ka cenuar integritetin e rezultatit të zgjedhjeve apo ka sjellë pavlefshmërinë e tyre, dënohet me burgim nga tre gjer në shtatë vjet dhe me gjobë nga treqind mijë gjer në gjashtëqind mijë lekë.”.

Neni 47

Pas nenit 326 shtohet neni 326/a me këtë përmbajtje:



“Neni 326/a

Dëmtimi me dashje i materialit zgjedhor

Dëmtimi, prishja, shkatërrimi me dashje, apo zëvendësimi në kundërshtim me ligjin i pajisjeve, vulave, kodeve të sigurisë apo çdo materiali tjetër zgjedhor të parashikuar nga ligji, dënohet me burgim nga gjashtë muaj gjer në pesë vjet.

Po këto vepra kur kryhen nga personat përgjegjës për administrimin zgjedhor ose në bashkëpunim, ose më shumë se një herë, apo kur kanë sjellë pasoja të rënda në mbarëvajtjen e zgjedhjeve, kanë sjellë pavlefshmërinë e tyre apo kanë cenuar rezultatin e votimit, dënohen me burgim nga tre gjer në tetë vjet dhe me gjobë nga dyqind mijë gjer në shtatëqind mijë lekë.”.

Neni 48

Neni 327 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 327

Shkelja e fshehtësisë së votimit

Shkelja e rregullave që garantojnë fshehtësinë e votimit nga ana e personave të ngarkuar me zgjedhjet, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me burgim nga tre muaj gjer në dy vjet.”.

Neni 49

Pas nenit 327 shtohet neni 327/a me këtë përmbajtje:

“Neni 327/a

Votimi më shumë se një herë ose pa u identifikuar

Votimi më shumë se një herë në të njëjtat zgjedhje, votimi për persona të tjerë, duke paraqitur dokumente identifikimi të rreme apo duke përdorur dokumente të zgjedhësve të tjerë dënohet me burgim nga një gjer në tre vjet.

Lejimi me dashje i kryerjes së kësaj vepre nga komisionerët zgjedhorë dënohet me burgim nga një gjer në pesë vjet.

Lejimi me dashje nga komisionerët zgjedhorë i votimit, pa kryer identifikimin e shtetasit sipas ligjit, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me burgim nga tre muaj gjer në një vit.”.

Neni 50

Neni 328 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 328

Dhënia e shpërblimeve dhe e premtimeve

Ofrimi ose dhënia e të hollave apo të mirave materiale, bërja e premtimeve për vende pune ose për favorizime të tjera në cilëndo formë, me qëllim që të marrë firmën për paraqitjen e kandidatit, për të votuar në një mënyrë të caktuar apo për të marrë pjesë ose jo në votime, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me burgim nga gjashtë muaj gjer në dy vjet.

Pranimi i të hollave, të mirave materiale, premtimeve dhe favorizimeve të tjera kundrejt kryerjes së veprimeve të mësipërme, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë.”.

Neni 51

Pas nenit 328 shtohet neni 328/a me këtë përmbajtje:

“Neni 328/a
Detyrimi për pjesëmarrje në veprimtari politike

Detyrimi i shtetasve nën varësi administrative, kundër vullnetit të tyre apo nën kanosjen e përdorimit të masave administrative, për të marrë pjesë në veprimtari zgjedhore të një subjekti zgjedhor përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në gjashtë muaj.

Detyrimi apo organizimi për të marrë pjesë në veprimtari elektorale të një subjekti zgjedhor i nxënësve të arsimit parauniversitar nga punonjës që kryejnë një detyrë shtetërore në arsimin publik, ose detyrë a funksion në arsimin jopublik, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me burgim nga tre muaj gjer në një vit.”.

Neni 52

Neni 329 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 329
Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje

Kanosja që i bëhet zgjedhësit për të votuar në një mënyrë të caktuar apo për të marrë pjesë ose jo në votime, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet nga tre muaj gjer në dy vjet.

Kanosja apo përdorimi i dhunës që i bëhet komisionerit, vëzhguesit, numëruesit si dhe çdo zyrtari tjetër të ngarkuar me zgjedhjet për ta penguar në kryerjen e detyrës apo për shkak të veprimtarisë së tij në administrimin zgjedhor dënohet me burgim nga gjashtë muaj gjer në tre vjet.

Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë dënohet me burgim nga një gjer në pesë vjet.”.

Neni 53

Neni 330 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 330
Pengimi i zgjedhësit

Pengimi i zgjedhësit për të votuar në qendrën e tij të votimit, duke shkelur rregullat e votimit, duke i marrë apo dëmtuar dokumentin e tij të identifikimit, apo në çdo formë tjetër, dënohet me burgim nga gjashtë muaj gjer në një vit.

Kur kjo vepër kryhet më shumë se një herë, ndaj më shumë se një zgjedhësi apo kur kryhet nga komisionerët zgjedhorë, dënohet me burgim nga një gjer në pesë vjet.”.

Neni 54

Pas nenit 330 shtohet neni 330/a me këtë përmbajtje:



“Neni 330/a

Braktisja e detyrës nga anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve

Braktisja e detyrës apo refuzimi për të kryer detyrën nga personat e ngarkuar me administrimin e procesit të votimit dhe të numërimit, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me burgim nga gjashtë muaj gjer në dy vjet.

Kur veprimet e mësipërme kryhen duke marrë me vete ose duke zhdukur materialet zgjedhore, ose kur kanë sjellë pasoja të rënda për procesin e votimit apo kanë çuar në pavlefshmërinë e zgjedhjeve, dënohet me burgim nga dy gjer në pesë vjet.”.

Neni 55

Neni 331 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 331

Shkelja e së drejtës së zgjedhjes

Mospërfshirja me dashje në listat e zgjedhësve e personave që e kanë të drejtën e zgjedhjes ose regjistrimi me dashje në to i personave që nuk e kanë këtë të drejtë, dënohet me burgim nga një gjer në pesë vjet.

Po kjo vepër e kryer në bashkëpunim, kur ka sjellë pasoja të rënda për interesat e zgjedhësve apo mbarëvajtjen e procesit zgjedhor dënohet me burgim nga dy gjer në pesë vjet dhe me gjobë nga treqind mijë gjer në shtatëqind mijë lekë.”.

Neni 56

Në nenin 86 paragrafi i fundit; në nenin 295/a paragrafët i parë, i dytë, i tretë, i pestë dhe i gjashtë; në nenin 298 paragrafi i parë; në nenin 311 dhe në nenin 313/b paragrafi i parë, fjalët “përbëjnë vepër penale dhe” hiqen.

Neni 57

Nenet 227, 229, 230/d, 239, 240 dhe 241 shfuqizohen.

Neni 58

Dispozitë kalimtare

Pushohen ndjekjet penale për çështjet në hetim, për çështjet e pashqyrtuara nga gjykatat, si dhe për kallëzimet, që ndodhen në këto organe dhe në organet e rendit publik, për veprat penale, të cilat shfuqizohen me hyrjen në fuqi të këtij ligji.

Neni 59

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 1.3.2012

**Shpallur me dekretin nr. 7341, datë 20.3.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

VENDIM
Nr. 13/2012

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË KOMISIONIT HETIMOR “PËR
NISJEN E PROCEDURËS SË SHKARKIMIT NGA DETYRA TË ZOTIT KRESHNIK SPAHIU,
ZËVENDËSKRYETAR I KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË”, NGRITUR ME
VENDIMIN E KUVENDIT NR. 2/2012, DHE SHKARKIMIN E TIJ**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 22 të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit” dhe të nenit 114 pika 3 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratimin e Raportit Përfundimtar, konkluzionet dhe rekomandimet e Komisionit Hetimor “Për nisjen e procedurës së shkarkimit nga detyra të zotit Kreshnik Spahiu, Zëvendëskryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë”.

II. Konstatimin e përmbushjes së kushteve të dëmtimit të pozitës dhe figurës së anëtarit, njëherazi Zëvendëskryetar i KLD-së, të zgjedhur me vendimin e Kuvendit nr. 114, datë 19.7.2007, z. Kreshnik Spahiu, për shkak të ushtrimit të detyrës në papajtueshmëri dhe në kundërshtim me ligjin.

III. Shkarkimin dhe ndërprerjen e menjëhershme të qëndrimit në detyrë të anëtarit të KLD-së, të zgjedhur nga Kuvendi, z. Kreshnik Spahiu.

IV. Dërgimin e Raportit Përfundimtar Prokurorit të Përgjithshëm, me qëllim që të vlerësojë gjetjet e këtij raporti për ushtrimin e ndjekjes penale.

V. Dërgimin e këtij vendimi pranë KLD-së, me qëllim ekzekutimin e ndërprerjes së menjëhershme të qëndrimit në detyrë si anëtar i KLD-së të z. Kreshnik Spahiu.

VI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

Miratuar në datën 1.3.2012



VENDIM
Nr. 14/2012

**PËR ZGJATJEN E AFATIT TË KOMISIONIT TË POSAÇËM PARLAMENTAR PËR
REFORMËN ZGJEDHORE, NGRITUR ME VENDIMIN NR. 141, DATË 17.11.2011**

Në mbështetje të neneve 78 pika 1 të Kushtetutës dhe të nenit 55 pika 1 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e bashkëkryetarëve të Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Afati i Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore, ngritur me vendimin nr. 141, datë 17.11.2011 zgjatet deri në datën 30.4.2012.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

Miraturar në datën 1.3.2012

DEKRET
Nr. 7294, datë 1.3.2012

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 dhe 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrisë të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

- | | |
|---------------------------------------|--------------------------------|
| 1. Manjola Hymerli Shabanllari | 17. Vilma Fatbardhi Murataj |
| 2. Sonila Hajri Dino (Saliu) | 18. Eduart Sami Atija |
| 3. Xheis Kadri Xhemali | 19. Alket Xhevit Biba |
| 4. Eljona Androkli Grindalen (Sterjo) | 20. Saimir Nexhat Guza |
| 5. Fatjon Xhuma Koprelli | 21. Ilir Mihal Jano |
| 6. Dorina Ferit Balliu | 22. Mardalena Koli Jano (Mile) |
| 7. Andi Kiço Joga | 23. Brian Michael Ilir Jano |
| 8. Alketa Ismet Dürbaum (Hoxhallari) | 24. Artur Eshref Teqja |
| 9. Erjon Hilmi Dardha | 25. Fisnik Muhamet Tirana |

- | | |
|--|------------------------------------|
| 10. Evis Astrit Manthey (Bishqemi) | 26. Jürgen (Jyrgen) Hysen Tallalli |
| 11. Ezmeralda Xhafer Dahl (Meto) | 27. Etleva Esat Sinaj |
| 12. Egi Gjin Ndrepepa | 28. Klaus Genc Halili |
| 13. Aida Gjovalin Baba (Deda) | 29. Mimoza Nikollë Lugaj |
| 14. Claudia Sokol Kastrati | 30. Fation Hasan Dervishi |
| 15. Mimoza Asllan Rizaj-Möller (Rizaj) | 31. Florjan Ibrahim Haçkaj |
| 16. Blerina Fatbardhi Murataj | |

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

VENDIM
Nr. 193, datë 26.3.2012

**PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN NË DETYRË TË DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM
TË AGJENCISË SË LEGALIZIMIT, URBANIZIMIT DHE INTEGRIMIT TË
ZONAVE/NDËRTIMEVE INFORMALE (ALUIZNI)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6 të vendimit nr. 289, datë 17.5.2006 të Këshillit të Ministrave “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrimit të Zonave/Ndërtimeve Informale (ALUIZNI)”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z. Shaban Memia, Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrimit të Zonave/Ndërtimeve Informale (ALUIZNI), lirohet nga kjo detyrë.

2. Z. Ardian Kollozi emërohet Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrimit të Zonave/Ndërtimeve Informale (ALUIZNI).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



UDHËZIM
Nr. 4, datë 28.2.2012

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 20, DATË 8.9.2011 “PËR
METODAT DHE PROCEDURAT E RAPORTIMIT TË SUBJEKTEVE RAPORTUESE TË
LIGJIT NR. 9917, DATË 19.5.2008 “PËR PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE DHE
FINANCIMIT TË TERRORIZMIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Shqipërisë dhe të nenit 28, pika 3 të ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar, me ligjin nr. 10 391, datë 3.3.2011 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit”, me propozim të autoritetit përgjegjës, Ministri i Financave

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 20, datë 8.9.2011 “Për metodat dhe procedurat e raportimit të subjekteve raportuese të ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” të ndryshuar”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime.

Neni 1

Në nenin 3, titulli “Identifikimi dhe verifikimi i klientit dhe pronarit përfitues” ndryshohet në “Vigjilenca e duhur”.

Në nenin 3, para pikës 1, shtohen pikat 1, 2 dhe 3 me përmbajtje:

1. Koncepti i “Vigjilencës së duhur ndaj klientit” shkon më tej se nocioni “Njih klientin tënd” dhe identifikimi i klientit është vetëm një prej elementeve të tij. Vigjilenca e duhur ndaj klientit është një proces dinamik, i vazhdueshëm që përbëhet nga katër masa të detyrueshme, që subjekteve u kërkohen në mënyrë që të konsiderohen në përputhje me detyrimet e tyre ligjore:

a) Identifikimi i klientit dhe verifikimi i këtij identifikimi nëpërmjet dokumenteve, të dhënave dhe informacioneve të tjera nga burime të besueshme dhe të pavarura. Masat e identifikimit dhe verifikimit janë dy procese të ndara por plotësuese që duhet të kryhen në përputhje me ligjin dhe këtë udhëzim;

b) Identifikimi i pronarit përfitues (person fizik) dhe verifikimi i këtij identifikimi duke ndërmarrë masa të arsyeshme në mënyrë që subjektet të krijojnë bindjen se kush është pronari përfitues përfundimtar.

Në rastin e personave juridikë dhe organizimeve të tjera ligjore masat e marra përfshijnë të kuptuarit e pronësisë dhe strukturës së kontrollit të tyre;

c) Mbledhja e informacionit mbi qëllimin dhe natyrën e caktuar të marrëdhënieve të biznesit;

d) Kryerjen e monitorimit të vazhdueshëm të marrëdhënieve të biznesit dhe të shqyrtimit të vazhdueshëm të transaksioneve për të siguruar që janë në përputhje me natyrën e biznesit të klientit dhe profilet e rrezikut, duke përfshirë, kur është e nevojshme, burimin e fondeve.

2. Përveç rasteve kur parashikohet në ligjin nr. 9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar, dhe në këtë udhëzim, masa të plota të vigjilencës së duhur ndaj klientit siç kërkohet në bazë të ligjit dhe të parashikuara në këtë udhëzim do të zbatohen në të gjitha rastet, siç përcaktohet në nenin 4 pika 1 të ligjit.

3. Subjektet duhet të aplikojnë masat e vigjilencës së duhur bazuar në nivelin e rrezikut. Krahas kategorive të përcaktuara në ligj, subjektet duhet të përcaktojnë kategori të tjera të klientëve dhe transaksioneve ndaj të cilave duhet të zbatohen masat e vigjilencës së zgjeruar. Për këtë qëllim subjektet

duhet të hartojnë dhe zbatojnë procedura dhe politika për të identifikuar shkallën e rrezikut sipas kategorive të klientëve apo marrëdhënieve të biznesit. Këto procedura dhe politika duhet të jenë në përputhje me aktivitetin e subjektit dhe në përpjesëtim me rrezikun e identifikuar. Politikat dhe procedurat e subjekteve duhet të bazohen në:

a) rrezikun që paraqet klienti, pozitën e tij gjeografike dhe tërësinë e produkteve dhe shërbimeve;

b) politikën e pranimi të klientëve dhe monitorimin e marrëdhënies së biznesit;

c) procesin e kategorizimit të klientëve sipas nivelit të rrezikut.

Në nenin 3 pikat 1, 2, 3, 4, 5 numërohen përkatësisht 4, 5, 6, 7, 8.

Në nenin 3 pika 4, fjalët "... subjektet bëjnë ..." zëvendësohen me fjalët "... subjektet duhet të bëjnë ..." dhe fjalët "... verifikimin e identitetit të tyre me anë të dokumenteve të vlefshme origjinale ose fotokopje të noterizuara ..." zëvendësohen me fjalët "... verifikimin e identitetit të tyre me anë të burimeve të pavarura dhe të besueshme nëpërmjet dokumenteve të vlefshme origjinale ose fotokopje të noterizuara".

Në nenin 3 pika 7, pas fjalisë "Subjektet duhet të identifikojnë dhe të verifikojnë identitetin e pronarit përfitues" shtohet në vijim "të cilët duhet të jenë gjithmonë persona fizik, në përputhje me parashikimin e pikës 4 të këtij neni, për individët".

Në nenin 3 shtohet pika 9 me përmbajtje "Pa cenuar parashikimet e nenit 4 pika 7 të këtij udhëzimi, subjektet duhet të verifikojnë identitetin e klientit dhe pronarit përfitues përpara ose gjatë vendosjes së marrëdhënies së biznesit ose kryerjes së një transaksioni për klientë të rastësishëm".

Neni 2

Neni 4, ndryshon përmbajtjen si në vijim:

"Masat e vigjilencës së duhur ndaj klientit"

Në kuadrin e zbatimit të vigjilencës së duhur ndaj klientit subjektet duhet:

1. Të hartojnë e të zbatojnë rregullore dhe udhëzime të brendshme për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, në të cilat përfshihen procedurat për vlerësimin dhe menaxhimin e riskut në marrëdhëniet e biznesit, për zbatimin e masave për vigjilencën e duhur ndaj klientit në përputhje me nivelin e riskut; për mbajtjen e të dhënave; për raportimin e aktivitetit të dyshimtë dhe transaksioneve mbi prapun e raportimit, si dhe për trajnimin e stafit të tyre.

2. Të mos hapin apo të mbajnë llogari anonime, llogari me emra fiktivë ose llogari të identifikuar vetëm nëpërmjet një numri. Masat e vigjilencës së duhur zbatohen dhe ndaj klientëve ekzistues nëse ata kanë hapur llogari të tilla.

3. Të identifikojnë klientin (të përhershëm apo rastësor, persona fizikë apo juridikë) dhe të verifikojë identitetin e klientit nëpërmjet dokumenteve, të dhënave apo informacioneve nga burime të besueshme dhe të pavarura siç përcaktohet në nenin 3 të këtij udhëzimi.

4. Të përcaktojnë për të gjithë klientët, para vendosjes së marrëdhënieve të biznesit apo gjatë procesit të monitorimit të kësaj marrëdhënieje, nëse ata janë duke vepruar në emër të një personi tjetër dhe duhet të marrin masa të arsyeshme për të siguruar të dhëna të mjaftueshme për identifikimin e atij personi dhe verifikimin e të dhënave në përputhje me nenin 3 të këtij udhëzimi.

5. Të marrin masa të mëposhtme për klientët që janë persona juridikë ose organizime të tjera ligjore:

a) Të verifikojë nëse çdo person që vepron në emër të klientit të tij është i autorizuar dhe të identifikojë dhe verifikojë identitetin e tij;

b) Të verifikojë statusin ligjor të personave juridikë nëpërmjet dokumenteve ligjore të themelimit dhe regjistrimit ose fakteve të ngjashme të ekzistencës së tyre dhe të sigurojë informacion në lidhje me emrin e klientit, emrat e kujdestarëve (për trustet), formën ligjore, adresën, drejtorët (për personat juridikë) dhe dispozitat që rregullojnë marrëdhëniet juridike;



c) Të kuptojnë strukturën e pronësisë dhe kontrollit të klientit;
d) Të verifikojë pronarin përfitues dhe të marrë masa të arsyeshme për të verifikuar identitetin e tij, nëpërmjet informacioneve përkatëse ose të dhënave të siguruara nga burime të besueshme në bazë të të cilave subjekti njeh se kush janë pronarët përfitues;

e) të përcaktojë individët, të cilët zotërojnë dhe kanë kontrollin e fundit mbi klientin. Këtu përfshihen ata individë që ushtrojnë kontrollin e fundit efektiv mbi personin juridik ose mbi organizime të tjera ligjore. Për personat juridikë kjo duhet të përfshijë dhe identifikimin e personave fizikë që kanë interesa kontrolluese dhe personave fizikë, të cilët formojnë pjesën drejtuese dhe menaxhuese të personit juridik. Në rast të organizimeve të tjera ligjore (trusteve) kjo përfshin dhe identifikimin e themeluesit, kujdestarit ose personit me një kontroll efektiv mbi trustin apo përfituesit.

6. Të sigurojnë informacion për qëllimin dhe natyrën e caktuar të marrëdhënies së biznesit me klientin, mbi bazën e të cilit mund të ndërtojnë profilin e riskut të klientit. Profili i riskut duhet t'u shërbejë subjekteve për të përcaktuar dhe zbatuar masat e vigjilencës së duhur ndaj klientit.

7. Të përcaktojnë procedurat dhe mjetet e menaxhimit të riskut për rastet kur mund të hyjnë në një marrëdhënie biznesi me klientin, përpara ose gjatë identifikimit të tij. Këto procedura duhet të përfshijnë një sërë masash, si kufizimin e numrit, të llojit dhe/ose të shumës së transaksioneve që mund të kryhen.

Marrëdhënia e biznesit mund të vendoset para apo gjatë verifikimit të identitetit të klientit vetëm në rastet kur:

- identifikimi i klientit nga subjekti do të kryhet sa më shpejt që të jetë praktikisht e mundur;
- është e nevojshme për të mos ndërprerë vazhdimin normal të aktivitetit të biznesit të subjektit;
- risku i pastrimit të parave menaxhohet në mënyrë normale nga subjekti.

8. Të përfundojnë marrëdhënien e biznesit dhe dërgojnë një raport të aktivitetit të dyshimtë tek autoriteti përgjegjës, në rastet kur kanë filluar marrëdhënien e biznesit sipas pikës 7 të këtij neni dhe si rezultat i mosparaqitjes së dokumenteve ose për çdo arsye tjetër, nuk janë të aftë të plotësojnë bindshëm kërkesat për identifikimin dhe verifikimin e klientit në përputhje me nenet 3 dhe 4 të këtij udhëzimi.

9. Të zbatojnë në vazhdimësi vigjilencën e duhur në marrëdhëniet e biznesit me një klient në përputhje me parashikimet e nenit 6 të këtij udhëzimi.

10. Të zbatojnë masat e vigjilencës së duhur dhe për klientët ekzistues, bazuar në nivelin e rrezikut të ekspozimit ndaj pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe të zbatojë vigjilencën e duhur ndaj klientit për rastet kur: transaksioni mund të jetë jashtë profilit të biznesit të klientit; standardet e dokumentacionit të klientit ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme. Ka një ndryshim thelbësor në përdorimin e llogarisë; është konstatuar se mungon informacion i mjaftueshëm për klientin. Subjektet nuk duhet ta marrin listën e mësipërme si gjithëpërfshirëse dhe kufizuese për të zbatuar vigjilencën e duhur për klientët ekzistues.

11. Ndërmarrin në përputhje me nenin 5 të këtij udhëzimi, masat e vigjilencës së zgjeruar për kategoritë e klientëve, marrëdhëniet e biznesit dhe transaksioneve me rrezik të lartë.

12. Kur subjektet janë të paaftë që të plotësojnë kënaqshëm detyrimet për vigjilencën e duhur ndaj klientit sipas paragrafëve nga a te c të pikës 1 të nenit 3 të këtij udhëzimi duhet:

- a) të mos hapin llogari, të mos fillojnë marrëdhënie biznesi dhe të mos kryejnë transaksione;
- b) të dërgojnë raport të aktivitetit të dyshimtë tek autoriteti përgjegjës.”.

Neni 3

Neni 5 ndryshon përmbajtjen si në vijim:

“Vigjilenca e zgjeruar

Vigjilenca e zgjeruar duhet të përfshijë masa plotësuese në përputhje me vigjilencën e duhur të përcaktuara në nenin 3 dhe nenin 4 të këtij udhëzimi për të parandaluar që marrëdhëniet e biznesit të

përfshihen në aktivitete me rrezik më të lartë. Në këtë kuadër subjektet duhet të aplikojnë masat për vlerësimin e riskut për të identifikuar rreziqet shtesë. Në funksion të zbatimit të vigjilencës së zgjeruar subjektet e këtij udhëzimi:

1. Duhet të zbatojnë vigjilencën e zgjeruar në marrëdhëniet e biznesit dhe transaksionet me trustet, klientët jorezidentë, shoqëri që kanë aksione të prurësit apo kategori të tjera të klientëve për të cilët masat e identifikimit mund të jetë e vështirë të aplikohen.

2. Duhet t'u kushtojnë vëmendje të veçantë të gjitha transaksioneve komplekse, me vlera të larta dhe të pazakonta, të cilat nuk kanë qëllim të dukshëm ekonomik ose ligjor dhe njëkohësisht të analizojnë arsyet dhe qëllimin e kryerjes së transaksioneve të tilla. Të dhënat mbi konkluzionet e analizave të dokumentacionit dhe qëllimi i këtyre transaksioneve duhet të mbahen me shkrim dhe të ruhen për një periudhë pesëvjeçare dhe t'u vihen në dispozicion autoritetit përgjegjës, autoriteteve mbikëqyrëse/licencuese dhe auditorëve të brendshëm apo të jashtëm.

3. Në rastet e vendosjes së marrëdhënies korrespondente, subjektet e germës "a" të nenit 3 të ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", të ndryshuar:

a) duhet të marrin masat e duhura në mënyrë që të sigurohen se bankat e huaja korrespondente nuk lejojnë që llogaritë e tyre të përdoren nga bankat guaskë;

b) nuk duhet të mbajnë apo të hyjnë në marrëdhënie korrespondente me banka, llogaritë e të cilave përdoren nga bankat guaskë;

c) në rastet kur evidentojnë apo konstatojnë se llogaritë e bankës korrespondente përdoren nga bankat guaskë, ato duhet të ndërpresin menjëherë marrëdhënien e biznesit dhe t'i raportojnë autoritetit përgjegjës;

d) duhet të mbledhin informacion të mjaftueshëm në lidhje me biznesin dhe të vlerësojnë përshtatshmërinë dhe efektivitetin e mjeteve të kontrollit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit të institucionit korrespondent, të vlerësojnë cilësinë e mbikëqyrjes së tij, të sigurojnë aprovimin e instancave më të larta të administrimit/menaxhimit dhe të dokumentojë përkatësisht për çdo institucion përgjegjës në lidhje me parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit përpara vendosjes së marrëdhënies së biznesit për shërbimet e bankave korrespondente.

e) për rastet kur marrëdhënia korrespondente përfshin mbajtjen e llogarive transitore duhet të sigurohen që banka korrespondente:

- ka ndërmarrë masat e vigjilencës së duhur për klientë që kanë akses të drejtpërdrejtë në këto llogari;

- është në gjendje nëse i kërkohet të paraqesë dokumentet e identifikimit të klientit.

Për qëllimin e këtij udhëzimi, "llogari transitore" është llogaria korrespondente që përdoret në mënyrë të drejtpërdrejtë nga palët e treta për të kryer transaksione të biznesit në emër të tyre.

4. Të përfshijnë në rregulloret dhe procedurat e brendshme politikat e vlerësimit dhe të menaxhimit të riskut të klientit, marrëdhënies së biznesit dhe transaksioneve për të përcaktuar, ndër të tjera, nëse një klient/pronar përfitues apo personat e lidhur me të janë persona të ekspozuar politikisht sipas përcaktimit në nenin 2 paragrafi 10 të ligjit nr. 9917 të datës 19.5.2008, të ndryshuar.

Në këtë kontekst subjektet duhet:

a) të kërkojnë informacion në burimet e disponueshme, të tilla si: lista e përditësuar e personave të ekspozuar politikisht vendas, bazat specifike të të dhënave (*Wordcheck*, *Factiva* etj.), si dhe burimet e hapura të informacionit për personat e huaj;

b) të marrin miratimin e drejtuesve të lartë për vendosjen e marrëdhënieve të biznesit apo vazhdimin e këtyre marrëdhënieve kur një klient ekzistues bëhet person i ekspozuar politikisht;

c) të kryejnë një monitorim në rritje dhe të vazhdueshëm të marrëdhënieve të biznesit me këta klientë;

d) të marrë masat e duhura për të përcaktuar burimin e pasurisë dhe burimin e fondeve.



Për qëllimin e këtij udhëzimi, “burimi i pasurisë” është përcaktuar si veprimtari ekonomike ose çdo veprimtari tjetër që gjeneron vlerën neto të personit dhe “burimi i fondeve” është përcaktuar si veprimtari ekonomike ose çdo veprimtari tjetër që gjeneron fonde për një transaksion të veçantë.

5. Të përfshijnë në rregulloret dhe procedurat e brendshme politikat e vlerësimit dhe menaxhimit të riskut të marrëdhënies së biznesit me klientë, të cilët janë organizata jofitimprurëse.

Në këtë kontekst subjektet duhet:

a) të kërkojnë dhe marrin të dhëna mbi natyrën e veprimtarisë, administrimit dhe drejtimit të tyre, si dhe burimin e fondeve;

b) të analizojnë një informacion të tillë nëpërmjet zbatimit të procedurave të menaxhimit të riskut;

c) të kryejnë një monitorim në rritje dhe të vazhdueshëm të marrëdhënieve të biznesit me këta klientë.

6. Nëse personat dhe subjektet e detyruara nuk mund të zbatojnë detyrimin e vigjilencës së zgjeruar ndaj klientit:

a) nuk duhet të hapin llogari, të fillojnë një marrëdhënie biznesi apo të kryejnë transaksione;

b) duhet të dërgojnë raport të aktivitetit të dyshimtë tek autoriteti përgjegjës.

7. Në rastet kur subjekti ka filluar marrëdhënien e biznesit, sipas pikës 7 të nenit 4, dhe si rezultat i mosparaqitjes së dokumenteve nga ana e klientit ose për arsye të tjera, është i paaftë të plotësojë bindshëm detyrimin e vigjilencës së duhur, personi apo subjekti i detyruar duhet të përfundojë marrëdhënien e biznesit dhe duhet të dërgojë raport të aktivitetit të dyshimtë tek autoriteti përgjegjës.”.

Neni 4

Në nenin 6 paragrafi 2, pas fjalisë “Ky proces kërkohet të ndërmerret veçanërisht për klientët apo marrëdhëniet e biznesit që kategorizohen me risk të lartë” shtohet si vijon “dhe duhet të zbatohet menjëherë kur ka arsye për të dyshuar se situata faktike e klientit ka ndryshuar”.

Neni 5

Për kontrollin e zbatimit të këtij udhëzimi ngarkohet autoriteti përgjegjës-Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP).

Neni 6

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

UDHËZIM
Nr. 5, datë 28.2.2012

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 21, DATË 8.9.2011 “PËR
MËNYRAT DHE PROCEDURAT E RAPORTIMIT TË PROFESIONEVE TË LIRA
JOFINANCIARE”**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Shqipërisë dhe të nenit 28 pika 3 të ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar me ligjin nr. 10 391, datë 3.3.2011 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit”, me propozim të autoritetit përgjegjës, Ministri i Financave

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 20, datë 8.9.2011 “Për metodat dhe procedurat e raportimit të subjekteve raportuese të ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” të ndryshuar”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 3, titulli “Identifikimi dhe verifikimi i klientit dhe pronarit përfitues” ndryshohet në “Vigjilenca e duhur”.

Në nenin 3, para pikës 1, shtohen pikat 1, 2 dhe 3, me përmbajtje:

“1. Koncepti i “Vigjilencës së duhur ndaj klientit” shkon më tej se nocioni “Njih klientin tënd” dhe identifikimi i klientit është vetëm një prej elementeve të tij. Vigjilenca e duhur ndaj klientit është një proces dinamik, i vazhdueshëm që përbëhet nga katër masa të detyrueshme, që subjekteve u kërkohen në mënyrë që të konsiderohen në përputhje me detyrimet e tyre ligjore:

a) Identifikimi i klientit dhe verifikimi i këtij identifikimi nëpërmjet dokumenteve, të dhënave dhe informacioneve të tjera nga burime të besueshme dhe të pavarura. Masat e identifikimit dhe verifikimit janë dy procese të ndara, por plotësuese që duhet të kryhen në përputhje me ligjin dhe këtë udhëzim;

b) Identifikimi i pronarit përfitues (person fizik) dhe verifikimi i këtij identifikimi duke ndërmarrë masa të arsyeshme, në mënyrë që subjektet të krijojnë bindjen se kush është pronari përfitues përfundimtar.

Në rastin e personave juridikë dhe organizimeve të tjera ligjore, masat e marra përfshijnë të kuptuarit e pronësisë dhe strukturës së kontrollit të tyre;

c) Mbledhja e informacionit mbi qëllimin dhe natyrën e caktuar të marrëdhënieve të biznesit;

d) Kryerjen e monitorimit të vazhdueshëm të marrëdhënieve të biznesit dhe të shqyrtimit të vazhdueshëm të transaksioneve për të siguruar që janë në përputhje me natyrën e biznesit të klientit dhe profilet e rrezikut, duke përfshirë, kur është e nevojshme, burimin e fondeve.

2. Përveç rasteve kur parashikohet në ligjin nr. 9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar, dhe në këtë udhëzim, masa të plota të vigjilencës së duhur ndaj klientit siç kërkohet në bazë të ligjit dhe të parashikuara në këtë udhëzim do të zbatohen në të gjitha rastet, siç përcaktohet në nenin 4 pika 1 të ligjit.

3. Subjektet duhet të aplikojnë masat e vigjilencës së duhur bazuar në nivelin e rrezikut. Krahas kategorive të përcaktuara në ligj, subjektet duhet të përcaktojnë kategori të tjera të klientëve dhe transaksioneve ndaj të cilave duhet të zbatohen masat e vigjilencës së zgjeruar. Për këtë qëllim subjektet duhet të hartojnë dhe zbatojnë procedura dhe politika për të identifikuar shkallën e rrezikut sipas kategorive të klientëve apo marrëdhënieve të biznesit. Këto procedura dhe politika duhet të jenë në



përputhje me aktivitetin e subjektit dhe në përpjesëtim me rrezikun e identifikuar. Politikat dhe procedurat e subjekteve duhet të bazohen në:

a) rrezikun që paraqet klienti, pozitën e tij gjeografike dhe tërësinë e produkteve dhe shërbimeve;

b) politikën e pranimit të klientëve dhe monitorimin e marrëdhënies së biznesit;

c) procesin e kategorizimit të klientëve sipas nivelit të rrezikut”.

Në nenin 3 pikat 1, 2, 3, 4, 5 numërtohen përkatësisht 4, 5, 6, 7, 8.

Në nenin 3, pika 4, fjalët “... subjektet bëjnë ...” zëvendësohen me fjalët “... subjektet duhet të bëjnë ...” dhe fjalët “... verifikimin e identitetit të tyre me anë të dokumenteve të vlefshme origjinale ose fotokopje të noterizuara ...” zëvendësohen me fjalët “... verifikimin e identitetit të tyre me anë të burimeve të pavarura dhe të besueshme nëpërmjet dokumenteve të vlefshme origjinale ose fotokopje të noterizuar”.

Në nenin 3 pika 7, pas fjalisë “Subjektet duhet të identifikojnë dhe të verifikojnë identitetin e pronarit përfitues” shtohet në vijim “të cilët duhet të jenë gjithmonë persona fizikë, në përputhje me parashikimin e pikës 4 të këtij neni, për individët”.

Në nenin 3 shtohet pika 9 me përmbajtje “Pa cenuar parashikimet e nenit 4 pika 6 të këtij udhëzimi, subjektet duhet të verifikojnë identitetin e klientit dhe pronarit përfitues përpara ose gjatë vendosjes së marrëdhënies së biznesit ose kryerjes së një transaksioni për klientë të rastësishëm”.

Neni 2

Neni 4, ndryshon përmbajtjen si në vijim:

“Masat e vigjilencës së duhur ndaj klientit

Në kuadrin e zbatimit të vigjilencës së duhur ndaj klientit subjektet duhet:

1. Të hartojnë e të zbatojnë rregullore dhe udhëzime të brendshme për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, në të cilat përfshihen procedurat për vlerësimin dhe menaxhimin e riskut në marrëdhëniet e biznesit, për zbatimin e masave për vigjilencën e duhur ndaj klientit në përputhje me nivelin e riskut; për mbajtjen e të dhënave; për raportimin e aktivitetit të dyshimtë dhe transaksioneve mbi pragun e raportimit, si dhe për trajnimin e stafit të tyre;

2. Të identifikojnë klientin (të përhershëm apo rastësor, persona fizikë apo juridikë) dhe të verifikojë identitetin e klientit nëpërmjet dokumenteve, të dhënave apo informacioneve nga burime të besueshme dhe të pavarura siç përcaktohet në nenin 3 të këtij udhëzimi.

3. Të përcaktojnë për të gjithë klientët, para vendosjes së marrëdhënies së biznesit apo gjatë procesit të monitorimit të kësaj marrëdhënieje, nëse ata janë duke vepruar në emër të një personi tjetër dhe duhet të marrin masa të arsyeshme për të siguruar të dhëna të mjaftueshme për identifikimin e atij personi dhe verifikimin e të dhënave në përputhje me nenin 3 të këtij udhëzimi.

4. Të marrin masat e mëposhtme për klientët që janë persona juridikë ose organizime të tjera ligjore:

a) të verifikojë nëse çdo person që vepron në emër të klientit të tij është i autorizuar dhe të identifikojë dhe verifikojë identitetin e tij;

b) të verifikojë statusin ligjor të personave juridikë nëpërmjet dokumenteve ligjore të themelimit dhe regjistrimit ose fakteve të ngjashme të ekzistencës së tyre dhe të sigurojë informacion në lidhje me emrin e klientit, emrat e kujdestarëve (për trustet), formën ligjore, adresën, drejtorët (për personat juridikë) dhe dispozitat që rregullojnë marrëdhëniet juridike;

c) të kuptojnë strukturën e pronësisë dhe kontrollit të klientit;

d) të verifikojë pronarin përfitues dhe të marrë masa të arsyeshme për të verifikuar identitetin e tij, nëpërmjet informacioneve përkatëse ose të dhënave të siguruar nga burime të besueshme, në bazë të të cilave subjekti njihet se kush janë pronarët përfitues;

e) të përcaktojnë individët të cilët zotërojnë dhe kanë kontrollin e fundit mbi klientin. Këtu përfshihen ata individë që ushtrojnë kontrollin e fundit efektiv mbi personin juridik ose mbi organizime të tjera ligjore. Për personat juridikë kjo duhet të përfshijë dhe identifikimin e personave fizikë që kanë interesa kontrolluese dhe personave fizikë, të cilët formojnë pjesën drejtuese dhe menaxhuese të personit juridik. Në rast të organizimeve të tjera ligjore (trusteve), kjo përfshin dhe identifikimin e themeluesit, kujdestarit ose personit me një kontroll efektiv mbi trustin apo përfituesit.

5. Të sigurojnë informacion për qëllimin dhe natyrën e caktuar të marrëdhënies së biznesit me klientin, mbi bazën e të cilit mund të ndërtojnë profilin e riskut të klientit. Profili i riskut duhet t'u shërbejë subjekteve për të përcaktuar dhe zbatuar masat e vigjilencës së duhur ndaj klientit.

6. Të përcaktojnë procedurat dhe mjetet e menaxhimit të riskut për rastet kur mund të hyjnë në një marrëdhënie biznesi me klientin, përpara ose gjatë identifikimit të tij. Këto procedura duhet të përfshijnë një sërë masash, si kufizimin e numrit, të llojit dhe/ose të shumës së transaksioneve që mund të kryhen.

Marrëdhënia e biznesit mund të vendoset para apo gjatë verifikimit të identitetit të klientit vetëm në rastet kur:

- identifikimi i klientit nga subjekti do të kryhet sa më shpejt që të jetë praktikisht e mundur;
- është e nevojshme për të mos ndërprerë vazhdimin normal të aktivitetit të biznesit të subjektit;
- risku i pastrimit të parave menaxhohet në mënyrë normale nga subjekti.

7. Të përfundojnë marrëdhënien e biznesit dhe të dërgojnë një raport të aktivitetit të dyshimtë tek autoriteti përgjegjës, në rastet kur kanë filluar marrëdhënien e biznesit sipas pikës 6 të këtij neni dhe si rezultat i mosparaqitjes së dokumenteve ose për çdo arsye tjetër, nuk janë të aftë të plotësojnë bindshëm kërkesat për identifikimin dhe verifikimin e klientit në përputhje me nenet 3 dhe 4 të këtij udhëzimi.

8. Të zbatojnë në vazhdimësi vigjilencën e duhur në marrëdhëniet e biznesit me një klient në përputhje me parashikimet e nenit 6 të këtij udhëzimi.

9. Të zbatojnë masat e vigjilencës së duhur dhe për klientët ekzistues, bazuar në nivelin e rrezikut të ekspozimit ndaj pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe të zbatojë vigjilencën e duhur ndaj klientit për rastet kur: transaksioni mund të jetë jashtë profilin të biznesit të klientit; standardet e dokumentacionit të klientit ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme; ka një ndryshim thelbësor në përdorimin e llogarisë; është konstatuar se mungon informacion i mjaftueshëm për klientin. Subjektet nuk duhet ta marrin listën e mësipërme si gjithëpërfshirëse dhe kufizuese për të zbatuar vigjilencën e duhur për klientët ekzistues.

10. Ndërmarrin, në përputhje me nenin 5 të këtij udhëzimi, masat e vigjilencës së zgjeruar për kategoritë e klientëve, marrëdhëniet e biznesit dhe transaksioneve me rrezik të lartë.

11. Kur subjektet janë të paafta që të plotësojnë kënaqshëm detyrimet për vigjilencën e duhur ndaj klientit sipas paragrafëve nga "a" të "c" të pikës 1 të nenit 3 të këtij udhëzimi duhet:

- a) të mos hapin llogari, të mos fillojnë marrëdhënie biznesi dhe të mos kryejnë transaksione;
- b) të dërgojnë raport të aktivitetit të dyshimtë tek autoriteti përgjegjës.”.

Neni 3

Neni 5 ndryshon përmbajtjen si në vijim:

“Vigjilenca e zgjeruar

Vigjilenca e zgjeruar duhet të përfshijë masa plotësuese në përputhje me vigjilencën e duhur të përcaktuara në nenin 3 dhe nenin 4 të këtij udhëzimi për të parandaluar që marrëdhëniet e biznesit të përfshihen në aktivitete me rrezik më të lartë. Në këtë kuadër subjektet duhet të aplikojnë masat për vlerësimin e riskut për të identifikuar rreziqet shtesë. Në funksion të zbatimit të vigjilencës së zgjeruar, subjektet e këtij udhëzimi:



1. Duhet të zbatojnë vigjilencën e zgjeruar në marrëdhëniet e biznesit dhe transaksionet me trustet, klientët jorezidentë, shoqëri që kanë aksione të prurësit apo kategori të tjera të klientëve, për të cilët masat e identifikimit mund të jetë e vështirë të aplikohen.

2. Duhet t'u kushtojnë vëmendje të veçantë të gjitha transaksioneve komplekse, me vlera të larta dhe të pazakonta, të cilat nuk kanë qëllim të dukshëm ekonomik ose ligjor dhe njëkohësisht të analizojnë arsyet dhe qëllimin e kryerjes së transaksioneve të tilla. Të dhënat mbi konkluzionet e analizave të dokumentacionit dhe qëllimi i këtyre transaksioneve duhet të mbahen me shkrim dhe të ruhen për një periudhë pesëvjeçare dhe t'u vihen në dispozicion autoritetit përgjegjës, autoriteteve mbikëqyrëse/licencuese dhe auditorëve të brendshëm apo të jashtëm.

3. Të përfshijnë në rregulloret dhe procedurat e brendshme politikat e vlerësimit dhe të menaxhimit të riskut të klientit, marrëdhënies së biznesit dhe transaksioneve për të përcaktuar, ndër të tjera, nëse një klient/pronar përfitues apo personat e lidhur me të janë persona të ekspozuar politikisht sipas përcaktimit në nenin 2, paragrafi 10 të ligjit nr. 9917 të datës 19.5.2008, të ndryshuar.

Në këtë kontekst, subjektet duhen:

a) të kërkojnë informacion në burimet e disponueshme, të tilla si: lista e përditësuar e personave të ekspozuar politikisht vendas, bazat specifike të të dhënave (*Worldcheck*, *Factiva* etj.), si dhe burimet e hapura të informacionit për personat e huaj;

b) të marrin miratimin e drejtuesve të lartë për vendosjen e marrëdhënieve të biznesit apo vazhdimin e këtyre marrëdhënieve kur një klient ekzistues bëhet person i ekspozuar politikisht;

c) të kryejnë një monitorim në rritje dhe të vazhdueshëm të marrëdhënieve të biznesit me këta klientë;

d) të marrë masat e duhura për të përcaktuar burimin e pasurisë dhe burimin e fondeve.

Për qëllimin e këtij udhëzimi, “burimi i pasurisë” është përcaktuar si veprimtari ekonomike ose çdo veprimtari tjetër që gjeneron vlerën neto të personit dhe “burimi i fondeve” është përcaktuar si veprimtari ekonomike ose çdo veprimtari tjetër që gjeneron fonde për një transaksion të veçantë.

4. Të përfshijnë në rregulloret dhe procedurat e brendshme politikat e vlerësimit dhe të menaxhimit të riskut të marrëdhënies së biznesit me klientë të cilët janë organizata jofitimprurëse.

Në këtë kontekst, subjektet duhet:

a) të kërkojnë dhe marrin të dhëna mbi natyrën e veprimtarisë, administrimit dhe drejtimit të tyre, si dhe burimin e fondeve;

b) të analizojnë një informacion të tillë nëpërmjet zbatimit të procedurave të menaxhimit të riskut;

c) të kryejnë një monitorim në rritje dhe të vazhdueshëm të marrëdhënieve të biznesit me këta klientë.

5. Nëse personat dhe subjektet e detyruara nuk mund të zbatojnë detyrimin e vigjilencës së zgjeruar ndaj klientit:

a) nuk duhet të hapin llogari, të fillojnë një marrëdhënie biznesi apo të kryejnë transaksione;

b) duhet të dërgojnë raport të aktivitetit të dyshimtë tek autoriteti përgjegjës.

6. Në rastet kur subjekti ka filluar marrëdhënien e biznesit, sipas pikës 6 të nenit 4 dhe si rezultat i mosparaqitjes së dokumenteve nga ana e klientit ose për arsye të tjera, është i paaftë të plotësojë bindshëm detyrimin e vigjilencës së duhur, personi apo subjekti i detyruar duhet të përfundojë marrëdhënien e biznesit dhe duhet të dërgojë raport të aktivitetit të dyshimtë tek autoriteti përgjegjës”.

Neni 4

Në nenin 6 paragrafi 2 pas fjalisë “Ky proces kërkohet të ndërmerret veçanërisht për klientët apo marrëdhëniet e biznesit që kategorizohen me risk të lartë” shtohet si vijon: “dhe duhet të zbatohet menjëherë kur ka arsye për të dyshuar se situata faktike e klientit ka ndryshuar”.

Neni 5

Për kontrollin e zbatimit të këtij udhëzimi ngarkohet autoriteti përgjegjës-Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP).

Neni 6

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

URDHËR
Nr. 46, datë 9.2.2012

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË “MASTER I SHKENCAVE” NË SHKOLLËN E LARTË UNIVERSITARE PRIVATE “SEVASTI DHE PARASHQEVI QIRJAZI”

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 44/1 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Hapjen, në përputhje me vendimin nr. 290, datë 20.12.2011 të Këshillit të Akreditimit, në shkollën e lartë universitare private “Sevasti dhe Parashqevi Qirjazi”, e programeve të studimit të ciklit të dytë, master i shkencave në:

- a) Financë;
- b) Kontabilitet;
- c) Administrim biznesi.

2. Programet e studimit të ciklit të dytë të përcaktuara në pikën 1 të këtij urdhri realizohen me 120 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike. Në përfundim të këtyre programeve të studimit lëshohet diplomë universitare “Master i shkencave” në fushën e arsimit të kryer.

3. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë, Këshilli i Akreditimit, Drejtoria e Zhvillimit të Arsimit Jopublik dhe shkolla e lartë universitare private “Sevasti dhe Parashqevi Qirjazi”.

Ku urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj



URDHËR
Nr. 59, datë 17.2.2012

PËR RIORGANIZIMIN E NJËSIVE KRYESORE “FAKULTETI I FARMACISË DHE STOMATOLOGJISË” E “FAKULTETI I INFERMIERISË” NË “FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORE” TË SHKOLLËS SË LARTË UNIVERSITARE JOPUBLIKE “UNIVERSITETI KRISTAL”

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikave 5 dhe 6 të nenit 41 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 761, datë 6.12.2005 “Për dhënien e lejes për hapjen e shkollës së lartë universitare, jopublike “Universiteti Kristal””,

URDHËROJ:

1. Riorganizimin e njësive kryesore “Fakulteti i Farmacisë dhe Stomatologjisë” e “Fakulteti i Infermierisë” në “Fakulteti i Shkencave Mjekësore” të shkollës së lartë universitare jopublike “Universiteti Kristal”, në përputhje me vendimin nr. 275, datë 4.11.2011 të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë, bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Fakulteti i Shkencave Mjekësore të ketë në përbërje këto njësi bazë:

- i) Departamenti i Infermieristikës;
- ii) Departamenti i Stomatologjisë;
- iii) Departamenti i Farmacisë;
- iv) Departamenti i Teknologjisë Mjekësore.

3. Ky institucion duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit institucional, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

4. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë, Këshilli i Akreditimit, Drejtoria e Zhvillimit të Arsimit Jopublik dhe shkolla e lartë universitare, jopublike “Universiteti Kristal”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

URDHËR
Nr. 60, datë 17.2.2012

**PËR LEJIMIN E FILLIMIT TË VEPRIMTARISË AKADEMIKE TË PROGRAMEVE TË
STUDIMIT, AKADEMISË PEDAGOGJIKE, TIRANË, NË PËRPUTHJE ME LICENCËN E
DHËNË**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 894, datë 21.12.2011 “Për licencimin e Akademisë Pedagogjike, Tiranë”,

URDHËROJ:

1. Lejimin e fillimit të veprimtarisë akademike të Akademisë Pedagogjike, Tiranë në Fakultetin e Edukimit, për programet e studimit të ciklit të parë “Bachelor” në mësuesi, në:

- a) Cikli parashkollor;
- b) Cikli i ulët;
- c) Gjuhë angleze.

2. Lejimin e fillimit të veprimtarisë akademike të Akademisë Pedagogjike, Tiranë në Fakultetin e Shkencave Sociale, për programet e studimit të ciklit të parë “Bachelor”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Bachelor” në:

- a) Pedagogji-histori;
- b) Pedagogji speciale;
- c) “Gazetari”, me profile:
 - i) Kulturë;
 - ii) Arsim;
 - iii) Shkencë.

3. Lejimin e fillimit të veprimtarisë akademike të Akademisë Pedagogjike, Tiranë, për programin e studimit të ciklit të dytë “Master profesional” në “Studime të thelluara në mjeshtëritë e mësimdhënies”.

4. Programet e studimeve “Bachelor” të përcaktuara në pikën 1 dhe pikën 2 të këtij urdhri, realizohen me 180 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është 3 vite akademike. Në përfundim të tyre lëshohet diplomë “Bachelor” në fushën e arsimit të kryer.

5. Programi i studimeve “Master profesional” të përcaktuar në pikën 3 të këtij urdhri realizohet me 90 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është 1.5 vite akademike. Në përfundim të tij lëshohet diplomë “Master profesional” në “Studime të thelluara në mjeshtëritë e mësimdhënies”.

6. Veprimtaria akademike, për programet e studimeve të sipërpërmendura në këtë urdhër, të fillojë në vitin akademik 2011-2012.

7. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Zhvillimit të Arsimit Jopublik dhe Akademia Pedagogjike, Tiranë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj



URDHËR
Nr. 62, datë 17.2.2012

**PËR LEJIMIN E FILLIMIT TË VEPRIMTARISË AKADEMIKE TË PROGRAMEVE TË
STUDIMIT, AKADEMISË SË STUDIMEVE TË APLIKUARA, DURRËS, NË PËRPUTHJE ME
LICENCËN E DHËNË**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 693, datë 12.10.2011 “Për licencimin e Akademisë së Studimeve të Aplikuara, Durrës”,

URDHËROJ:

1. Lejimin e fillimit të veprimtarisë akademike të Akademisë së Studimeve të Aplikuara, Durrës, për programet e studimit të ciklit të parë “Bachelor” në:

- a) Menaxhim biznesi;
- b) Financë;
- c) Mësuesi për arsimin fillor;
- d) Mësuesi për arsimin parashkollor;
- e) Drejtësi;
- f) Infermieri.

2. Programet e studimeve “Bachelor” të përcaktuara në pikën 1 të këtij urdhri, realizohen me 180 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është 3 vite akademike. Në përfundim të tyre lëshohet diplomë “Bachelor” në fushën e arsimit të kryer.

3. Veprimtaria akademike, për programet e studimeve të sipërpërmendura në këtë urdhër, të fillojë në vitin akademik 2011-2012.

4. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Zhvillimit të Arsimit Jopublik dhe Akademia e Studimeve të Aplikuara, Durrës.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 25.3.2012
Doli nga shtypi më 27.3.2012

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2012

Çmimi 44 lekë